

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

Nr.	Përmbajtja	Figura	Përgjigja
<b>TEMA I : PERIUDHA E DREJTIMIT DHE PUSHIMIT. RREGULLAT PËR KOHËN (ORËT) E DREJTIMIT TË MJETIT DHE PERIUDHAT E PUSHIMIT</b>			
1	Të drejtosh autobusin për katër orë rresht, pa ndërprerje, përbën shkelje administrative		Gabim
2	Pas një periudhe drejtimi prej katër orësh e gjysmë, drejtuesi i autobusit duhet të respektojë një periudhë pushimi të paktën 50 minuta rresht		Gabim
3	Kohëzgjatja ditore e drejtimit të autobusit, për një drejtues, lejohet të shtrihet deri në 10 orë, por jo më shumë se 2 herë në javë		Saktë
4	Kohëzgjatja e drejtimit të pandërprerë të autobusit, për një drejtues, nuk mund të jetë më shumë se 4 orë e 30 minuta, përveç rasteve kur nuk mund të gjendet sheshpushim që mund të shkojë deri në 5 orë		Saktë
5	Periudhat kohore të përdorura për pastrimin e autobusit konsiderohen "kohë të gatishmërisë"		Gabim
6	Ne rast se drejtuesi i autobusit ndërpret drejtimin për dyzet e pesë minuta pas katër orë e gjysmë në drejtim e tij i nënshtrohet një sanksioni administrativ		Gabim
7	Kohëzgjatja ditore e drejtimit të autobusit, për një drejtues, mund të jetë e ndarë në 2 periudha drejtimi të pandërprera, secila prej 4 orë e 30 minuta		Saktë
8	Periudhat e ndërprerjeve, të pushimeve dhe të gatishmërisë nuk përfshihen në llogaritjet e kohës së punës		Saktë
9	Kohëzgjatja ditore e drejtimit të autobusit, për një drejtues, nuk duhet t'i kalojë 9 orë, përveç rasteve që mund të jete deri në 10 orë, por jo më shumë se dy herë në javë		Saktë
10	Për një drejtues autobusi koha maksimale e drejtimit ditor mund të jetë e ndarë në 2 periudha drejtimi të pandërprera ku njëra është 6 orë		Gabim
11	Koha maksimale e drejtimit ditor, për një drejtues autobusi, nuk mund të jetë më shumë se 3 orë e 30 minuta pa ndërprerje		Gabim
12	Pushimi prej të paktën 45 minuta që duhet të bëjë drejtuesi i autobusit, pas periudhës së drejtimit të pandërprerë, mund të bëhet i ndarë në 3 periudha 15 minutëshe		Gabim
13	Gjatë drejtimit të autobusit është e lejueshme të përdorni një fletë regjistrimi të tahografit analog për më shumë se 24 orë		Gabim
14	Periudhat kohore të shpenzuara për shërbimin ditor të autobusëve, konsiderohen "punë të tjera"		Saktë
15	"Kohë e gatishmërisë" konsiderohet koha në të cilën drejtuesi I mjetit duhet të jetë i gatshëm për të qenë në gjendje të rifillojë punën menjëherë, megjithëse jo domosdoshmërisht duhet të mbetet në vendin e punës		Saktë
16	Periudhat kohore të përdorura për pastrimin e autobusit konsiderohen "kohë të gatishmërisë"		Gabim
17	Kohët e përcaktuara si "punë të tjera" konsiderohen si kohë lëvizëse		Gabim
18	Kohëzgjatja javore e drejtimit të mjetit, për një drejtues, nuk duhet ti kapërcejë 56 orë ndërmjet periudhave të pushimit javor ose 58 orë nëse kohëzgjatja e drejtimit 6 ditor shtrihet në dy javë		Saktë
19	Rregullorja për organizimin e kohës së punës për drejtuesit e mjeteve, ka si qëllim të rrisë nivelin e sigurisë rrugore		Saktë
20	"Kohët e gatishmërisë" janë ato gjatë të cilave drejtuesi mund të disponojë lirisht kohën e tij		Gabim
21	Kohëzgjatja e përgjithshme e drejtimit të mjetit gjatë 2 javëve të njëpasnjëshme nuk duhet ti kapërcejë 90 orë		Saktë
22	Në tahografin digjital, kohët e përcaktuara si "punë të tjera", tregohen nga simboli në figurë	951	Gabim
23	Në tahografin digjital, kohët e përcaktuara si "kohë gatishmërie", tregohen nga simboli në figurë	951	Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
24	Në tahografin digjital, kohët e përcaktuara si "punë të tjera", tregohen nga simboli në figurë	950	Gabim
25	Koha e drejtimit të autobusit për një drejtues, nuk mund të jetë më shumë se 50 orë në një javë		Gabim
26	Periodha e ndërprerjeve të drejtimit të autobusit, është jo më pak se 45 minuta, kur mjetei është drejtuar për 4 orë e 30 minuta pa ndërprerje		Saktë
27	Kohëzgjatja e ndërprerjeve të drejtimit të autobusit, duhet të jetë jo më pak se 50 minuta, kur mjetei është drejtuar për 4 orë e 30 minuta pa ndërprerje		Gabim
28	Periodha e pushimit ditor e drejtuesit të autobusit, është periodha e pushimit të pandërprerë brenda kohës prej 24 orësh		Saktë
29	Periodha e pushimit ditor e drejtuesit të autobusit është jo më pak se 11 orë të vazhdueshme që mund të reduktohet minimumi në 9 orë, por jo më shumë se 3 herë në javë		Saktë
30	Periodha e pushimit ditore lejohet te reduktohet ne një minimum prej 9 ore, por jo me shume se 3 here ne jave		Saktë
31	Periodha e pushimit ditor e drejtuesit të autobusit, mund të bëhet e ndarë në dy pjesë nga 6 orë secila		Gabim
32	Periodha e pushimit ditor e drejtuesit të autobusit duhet të jetë 8 orë		Gabim
33	Drejtuesi i mjetit nuk përjashtohet nga përgjegjësia për shkeljet e rregullores se organizimit të kohës së punës në transportin rrugor, kur mjetei është në pronësi të kompanisë		Saktë
34	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, synon të rrisë orarin e punës		Gabim
35	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, parashikon që periodha e pushimit javor mund të jetë e llojit të rregullt ose të reduktuar		Saktë
36	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, zbatohet gjithashtu edhe për transportin hekurudhor		Gabim
37	Kompania e transportit mund të ulë pagën e drejtuesit, i cili refuzon të drejtojë autobusin për më shumë se 10 orë në ditë		Gabim
38	Kompania e transportit nuk është përgjegjëse për shkeljet e legjislacionit për drejtimin dhe kohën e pushimit të kryera, gjatë punës, nga drejtuesit e punësuar prej tyre kur janë jashtë vendit		Gabim
39	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, në transportin rrugor, zbatohet për transportin rrugor të udhëtarëve me automjete qe kane me shume se nëntë ndenjese		Saktë
40	Prezenca e drejtuesit të dytë, kur ka dy drejtues në bord të automjetit për të gjithë periudhën, përveç tre orëve të para është opsionale		Gabim
41	Kur në mjet ndodhet më shumë se një drejtues, ndërkohë që njeri është duke drejtuar mjetin, drejtuesit e tjerë lejohet të marrin një periudhë të pushimit ditor		Gabim
42	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, ne transportin rrugor, parashikon dispozita në lidhje me transportin e mallrave, por jo me transportin e udhëtareve		Gabim
43	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, në transportin rrugor, parashikon që drejtuesi, në këmbim të një pagese shtese mund të heqë dorë nga periodha e pushimit javor		Gabim
44	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve te mjeteve, në transportin rrugor, parashikon dispozita në lidhje me kohën maksimale të lejuar në drejtim të autobusëve në një javë		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
45	Rregullorja për organizimin e kohës së punës të drejtuesve të mjeteve, në transportin rrugor, parashikon dispozita për pagat minimale të drejtuesve të autobusëve		Gabim
<b>TEMA II : PAJISJA REGJISTRUESE (TAHOGRAFI). PËRDORIMI I PAJISJEVE TË REGJISTRIMIT</b>			
46	Drejtuesi i mjetit të pajisur me tahograf, para se të fillojë udhëtimin duhet të sigurohet që e ka futur kartën e tij në folenë e tahografit		Saktë
47	Tahografi regjistron shpejtësinë e lëvizjes, kohën e drejtimit dhe kohën e ndërprerjes së drejtimit të automjetit		Saktë
48	Tahografi tregon edhe kohën e drejtimit të automjetit për çdo drejtues, kur mjete drejtohet nga disa drejtues		Saktë
49	Tahografi tregon edhe kohën e ndërprerjeve të drejtimit të automjetit nga drejtuesit e tij		Saktë
50	Tahografi tregon vetëm kohën e pushimit të drejtuesit të mjetit		Gabim
51	Tahografi tregon numrin e rrotullimeve të boshtit motorik		Gabim
52	Tahografi tregon vetëm kohën e ndërprerjeve të drejtimit të mjetit nga drejtuesit		Gabim
53	Autobusët për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve janë të pajisur me tahograf i cili duhet të jetë funksional		Saktë
54	Në tahografin digjital është e mundur të ruhen të dhëna në lidhje me aktivitetet e një ose dy drejtuesve të mjeteve		Saktë
55	Nga kujtesa e tahografit digjital është e mundur të printoni aktivitetet e ditës së punës së drejtuesit, ngjarjet dhe anomalitë, tejkalimet e shpejtësisë se lejuar dhe të dhënat teknike		Saktë
56	Autobusët në shërbimin e planifikuar publik, por të përdorura edhe në udhëtimet "jashtë linje", duhet të pajisen me një tahograf		Saktë
57	Fletët e regjistrimeve të tahografëve analogë duhet të kenë një kapacitet minimal regjistrimi prej 24 orësh		Saktë
58	Nga kujtesa e kartës së tahografit të drejtuesit është e mundur të gjurmohet aktiviteti i punës në 365 ditëve e mëparshme		Gabim
59	Autobusët në shërbimin e linjave të rregullta, kur itinerari i saj, nuk i kalon 50 km duhet të jetë i pajisur me një tahograf		Gabim
60	Drejtuesi i autobusit që kryejnë transport ndërkombëtar të udhëtarëve mund të pajiset me dy karta të ndryshme të tahografit		Gabim
61	Fletët e regjistrimeve të tahografëve analogë duhet të jenë të një lloji të aprovuar		Saktë
62	Në ekranin e tahografit digjital, kohët "punë të tjera" tregohen nga simboli në figurë	950	Gabim
63	Në ekranin e tahografit digjital, "kohët e gatishmërisë" tregohen nga simboli në figurë	952	Gabim
64	Në ekranin e tahografit digjital, "kohët e gatishmërisë" tregohen nga simboli në figurë	953	Gabim
65	Në ekranin e tahografit digjital, simboli në figurë, tregon funksionin "traget ose tren"	954	Saktë
66	Në ekranin e tahografit digjital, simboli në figurë, tregon "aktivitetet e drejtimit"	954	Gabim
67	Ekzistojnë katër lloje të kartave të tahografit: karta e drejtuesit, karta e kompanisë, karta e oficinës dhe karta e zyrtarit të kontrollit		Saktë
68	Në ekranin digjital të tahografit, simboli në figurë, tregon "aktivitetet rekreative"	955	Gabim
69	Në ekranin e tahografit digjital, simboli në figurë, tregon temën "kontroll"	956	Saktë
70	Në ekranin digjital të tahografit, simboli në figurë, tregon "pushimin javor"	956	Gabim
71	Në ekranin e tahografit digjital, simboli në figurë, tregon "madhësinë e gomës"	957	Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
72	Në takograf, "kohët e drejtimit" tregohen nga simboli në figurën 957	957	Saktë
73	Në ekranin e tahografit digjital, simboli në figurë, tregon mënyrën "jashtë kompetencës"	958	Gabim
74	Në ekranin e tahografit digjital, simboli në figurë, tregon "ndërprerjet e drejtimit"	958	Saktë
75	Në ekranin e tahografit digjital, kohët e drejtimit tregohen nga simboli në figurë	959	Gabim
76	Në ekranin e tahografit digjital, kohët e pushimit tregohen nga simboli në figurë	959	Saktë
77	Në ekranin e tahografit digjital, simboli në figurë, tregon funksionin "kompani"	960	Saktë
78	Në ekranin e tahografit digjital, simboli në figurë, tregon mënyrën e transportit "traget ose tren"	960	Gabim
79	Drejtuesi i një autobusi të pajisur me tahograf analog, para se të fillojë udhëtimin, duhet të shkruajë datën e transportit të fundit të kryer jashtë vendit në fletën e regjistrimit që do të përdorë		Gabim
80	Drejtuesi i një autobusi të pajisur me tahograf analog, para se të fillojë udhëtimin, duhet të shkruajë datën e nisjes në fletën e regjistrimit që do të përdorë		Saktë
81	Drejtuesi i një autobusi të pajisur me tahograf analog, para se të fillojë udhëtimin, duhet të shkruajë leximin e kilometrazhit në kohën e nisjes në fletën e regjistrimit që do të përdorë		Saktë
82	Para fillimit të udhëtimit, drejtuesi i një autobusi të pajisur me një tahograf analog duhet të shkruajë datën e tij të lindjes në fletën e regjistrimit që do të përdorë		Gabim
83	Drejtuesi i një autobusi të pajisur me tahograf analog, para se të fillojë udhëtimin, duhet të shkruajë numrin dhe kategorinë e lejes së tij të drejtimit në fletën e regjistrimit që do të përdorë		Gabim
84	Tahografi digjital duhet të kalibrohet para se automjeti të vihet në qarkullim		Saktë
85	Tahografi digjital është i pajisur me një printer të integruar		Saktë
86	Tahografi digjital është një pajisje që ruan të dhëna në lidhje me 5 vitet e fundit		Gabim
87	Tahografi digjital është një pajisje që mund të regjistrojë vetëm aktivitetin e një drejtuesi të vetëm		Gabim
88	Tahografi digjital është një pajisje që regjistron aktivitetet e drejtuesit, por jo të dhëna që lidhen me automjetin		Gabim
89	Tahografi digjital lëshon një sinjal akustik që paralajmëron nëse automjeti po përdoret pa futur kartën e tahografit të drejtuesit		Saktë
90	Tahografi digjital është një instrument matës që regjistron distancat, shpejtësitë, kohët e drejtimit dhe aktivitete të tjera të drejtuesit		Saktë
91	Tahografi digjital mund të montohet vetëm nga servise të autorizuara		Saktë
92	Tahografi digjital mund të riparohet nga çdo servis i pajisur në mënyrë të përshtatshme		Gabim
93	Tahografi digjital përdor karta takograf të lëshuara nga Dhoma e Tregtisë		Gabim
94	Tahografi digjital duhet të instalohet në të gjitha automjetet, madje edhe në ata që kanë të vendosur tahografin analog		Gabim
95	Takografi është i detyrueshëm për të gjithë autobusët		Gabim
96	Takografi është i detyrueshëm për automjetet për transportin e udhëtarëve me më shumë se 9 vende (përfshirë atë të drejtuesit), që kryejnë shërbime në linja të rregullta në distance mbi 50 km		Saktë
97	Takografi regjistron itinerarin e përshkruar nga autobusi		Gabim
98	Tahografi regjistron, duke iu referuar autobusit ku është vendosur, kilometrat e përshkruar dhe shpejtësitë e arritura		Saktë
99	Në rast të defektit të tahografit, nëse udhëtimi zgjat më pak se 7 ditë, drejtuesi mund të rregullojë avarinë kur të kthehet në shtëpi		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
100	Në rast të defektit të tahografit, si analog dhe digjital, drejtuesi duhet të bëjë regjistrimet e duhura manuale të veprimtarisë së tij		Saktë
101	Nëse karta e tahografit humbet, dëmtohet ose vidhet, drejtuesi duhet ta raportojë atë në zyrën e punës		Gabim
102	Nëse gjate drejtimit te mjetit kufijtë e shpejtësisë tejkalohe me më shumë se 40 km / orë, karta e tahografit të drejtuesit pezullohet për një periudhë prej tre muajsh		Gabim
103	Vendosja e kartës se drejtuesit në tahografin digjital duhet të bëhet me çelësin e ndezjes të futur dhe automjetin e ndaluar		Saktë
104	Tahografi vendoset në të gjitha automjetet		Gabim
105	Tahografi, vendoset vetëm në autobusët e shërbimit interurban		Gabim
106	Tahografi digjital përbëhet nga ekrani, tastiera, printeri dhe karta e tij		Saktë
107	Tahografi digjital ka dy vende për futjen e kartave të regjistrimit		Saktë
108	Tahografi digjital regjistron dhe ruan të dhënat sipas datave të qarkullimit me autobus		Saktë
109	Tahografi digjital regjistron edhe periudhën e pushimit të drejtuesit të mjetit		Saktë
110	Tahografi digjital ka vetëm një vend për futjen e kartës		Gabim
111	Tahografi digjital regjistron vetëm kohët e punës së drejtuesit të mjetit		Gabim
112	Tahografi digjital e merr lëvizjen nga boshti motorik		Gabim
113	Automjetet qe përdoren për përgatitjen e kandidateve për leje drejtimi përjashtohen nga përdorimi i tahografit, me kusht që të mos përdoren për transport tregtar të mallrave dhe udhëtarëve		Saktë
114	Autobusët që përdoren për transport për të tretë ose me qira përjashtohen nga përdorimi i tahografit		Gabim
115	Cilido që qarkullon me një mjet që është i pa pajisur me tahograf, në rastin kur është parashikuar pajisja me të, ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Saktë
116	Përjashtohen nga përdorimi i tahografit mjetet me shpejtësi maksimale te autorizuar deri ne 40 kilometra në orë		Saktë
117	Cilido që qarkullon me një mjet që është i pajisur me tahograf, por ai nuk funksionon ose nuk plotëson kërkesat e caktuara me ligj, ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Saktë
118	Cilido që qarkullon me një mjet që është i pajisur me tahograf, por nuk është futur karta e tahografit të drejtuesit, ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Saktë
119	Cilido që qarkullon me një mjet që ka të vendosur një tahograf i cili është digjital dhe jo analog, ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Gabim
120	Cilido që qarkullon me një mjet të pajisur me tahograf ndëshkohet me gjobë dhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejedrejtimit		Gabim
121	Nëse brenda 1 viti, konstatohen tri shkelje të përsëritura të qarkullimit të mjetit pa tahograf, për mjetet qe e kane detyrim vendosjen e tahografit, përveç gjobës dhe pezullimit të lejedrejtimit (2 deri 3 muaj), merret edhe masë administrative plotësuese e pezullimit të lejes së transportit për 1 vit		Saktë
122	Për qarkullim me mjet të pa pajisur me tahograf, në rastet kur është parashikuar pajisja me të, përveç gjobës dhe pezullimit të lejedrejtimit për drejtuesin, ndëshkohet me gjobë edhe mbajtësi i licencës ose i autorizimit të mjetit		Saktë
123	Në rast se pas 10 ditëve nga data e konstatimit te qarkullimit te mjetit me tahograf me defekt, nuk është rregulluar pajisja dhe qarkullohet me mjet bëhet ndalimi administrativ i mjetit		Saktë
124	Para nisjes së ditës së punës, drejtuesi i mjetit duhet të vendosi kartën e tahografit		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
125	Nëse humbet karta e tahogرافit te drejtuesit të mjetit duhet të aplikohet për zëvendësim brenda 7 ditëve mbasi te jete bere denoncimi		Saktë
126	Nëse mjete nuk është i pajisur me tahogراف, drejtuesi i mjetit është i përjashtuar gjithmonë nga mbajtja e regjistrimeve		Gabim
127	Nëse tahogرافi keq funksionon, drejtuesi mund të vazhdojë udhëtimin duke shënuar me dorë aktivitetet e tij, pasi te ketë njoftuar kompaninë		Saktë
128	Nëse tahogرافi pëson defekt drejtuesi i mjetit duhet të ndërpresë gjithmonë udhëtimin deri në riparimin e tij		Gabim
129	Tejkalimi i shpejtësisë së lëvizjes për më pak se një minutë nuk do të regjistrohet si shkelje nga tahogرافi		Saktë
130	Tejkalimi i shpejtësisë së lëvizjes për më pak se pesë minuta nuk do të regjistrohet si shkelje nga tahogرافi		Gabim
<b>TEMA III : LEGJISLACIONI PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE</b>			
131	Autobusi është mjet me motor i destinuar për transport njerëzish, me më shumë se 9 ndenjësë, përfshirë edhe atë të drejtuesit të mjetit		Saktë
132	Autobusi ka vende edhe për transportin e bagazheve të udhëtarëve		Saktë
133	Autobusi është mjet me motor i destinuar për transport njerëzish, vetëm kur ka mbi 30 ndenjësë		Gabim
134	Numri i udhëtarëve në këmbë ne një autobus mund të jetë me i madh se sa ai i shënuari në lejen e qarkullimit		Gabim
135	Autobusi është mjet me motor i destinuar për transport mallrash		Gabim
136	Gjerësia maksimale për autobusët nuk duhet të jetë më e madhe se 2.55 metra, pa pasqyrat e shikimit prapa		Saktë
137	Gjerësia maksimale mund të jetë edhe më e madhe se 2.55 metra, për autobusët urban		Gabim
138	Lartësia maksimale, duke përfshirë çdo lloj pajisje te vendosur sipër, mund të jetë deri në 4.3 metra, për autobusët e linjave publike urbane dhe interurbane		Saktë
139	Lartësia maksimale, duke përfshirë çdo lloj pajisje te vendosur sipër, duhet të jetë 4.3 metra, për të gjithë llojet e autobusëve		Gabim
140	Lartësia maksimale, duke përfshirë çdo lloj pajisje te vendosur sipër, mund të jetë deri në 4.5 metra, për autobusët e linjave urbane		Gabim
141	Gjatësia maksimale, përfshirë mekanizmat tërheqës, mund të jetë deri 18 metra për autobusët artikularë të linjave të shërbimit publik të pasagjerëve që qarkullojnë në itinerare të përcaktuara		Saktë
142	Gjatësia maksimale, përfshirë mekanizmat tërheqës, mund të jetë deri 18.75 metra për autobusët artikularë		Gabim
143	Gjatësia maksimale, përfshirë mekanizmat tërheqës, mund të jetë mbi 12 metra për autobusët tek me dy a më shumë akse		Gabim
144	Numri i udhëtarëve që transportohen me autobus të artikuluar, nuk mund ta kalojë atë të treguar në lejen e qarkullimit		Saktë
145	Numri i udhëtarëve që transportohen me autobus, duhet të jetë i tillë që të mos kufizojnë lirshmërinë e drejtuesit të mjetit		Saktë
146	Numri i udhëtarëve që transportohen me autobus, duhet të jetë i tillë që të mos pengojnë fushëpamjen e drejtuesit të mjetit		Saktë
147	Numri i udhëtarëve që transportohen me autobus te shërbimit urban, mund të jetë më i madh se i ndenjësëve, por jo të kalojë vlerat maksimale të shënuar në lejeqarkullimi		Saktë
148	Numri i udhëtarëve në autobusët e shërbimit urban nuk është i përcaktuar, por varet nga kërkesat për këtë shërbim		Gabim
149	Cilido që drejton një autobus, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, kur numri i pasagjereve është më i madh se ai i treguar në lejen e qarkullimit		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
150	Licenca është dokument i detyrueshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve		Saktë
151	Autorizimi është dokument i detyrueshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, për shërbime në linja të rregullta		Saktë
152	Autorizimi bilateral, për shërbimet vajtje-ardhje (lavjerrës), është dokument i nevojshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve		Saktë
153	Autorizimi i lëshuar për agjenci transporti është i vetmi dokument i nevojshëm për autobusët për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve		Gabim
154	Licenca është dokument i nevojshëm për shërbimet e rastit në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve		Gabim
155	Transporti i udhëtarëve, organizohet nga agjencia e transportit të udhëtarëve		Saktë
156	Transporti i udhëtarëve, shërben vetëm për transportin e bagazheve		Gabim
157	Transporti i udhëtarëve, lejohet të bëhet me kamionë		Gabim
158	Transporti i udhëtarëve brenda vendit, bëhet me çdo lloj automjeti mjafton të jetë në gjendje të mire teknike		Gabim
159	Transporti i udhëtarëve brenda vendit kryhet vetëm me ato mjete që për tu drejtuar, kërkojnë lejedrejtimi të kategorisë C		Gabim
160	Transporti i udhëtarëve brenda vendit kryhet vetëm me ato mjete që për tu drejtuar, kërkojnë lejedrejtimi të kategorisë C1E		Gabim
161	Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve kryhet vetëm me ato mjete që për tu drejtuar, kërkojnë lejedrejtimi të kategorisë C		Gabim
162	Shërbimi në linja të rregullta, është transporti i udhëtarëve në itinerare (linja) dhe vendqëndrime të përcaktuara		Saktë
163	Shërbimi në linja të rregullta, plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë kryhet me autobus dhe autovetura 8+1 vende, për rastet që lejohet		Saktë
164	Drejtuuesi i mjetit në shërbimin në linja të rregullta, mund të ndryshohen itinerarin sipas kërkesave të udhëtarëve		Gabim
165	Shërbimi në linja të rregullta, nuk ka nevojë për licencë		Gabim
166	Brenda autobusit, që punon në linjë ndërqytetëse, duhet të jenë afishuar oraret dhe vendqëndrimet e autobusit		Saktë
167	Brenda autobusit, që punon në linjë ndërqytetëse, duhet të jetë afishuar pjesë e rregullores së udhëtimit që i intereson direkt udhëtarëve		Saktë
168	Brenda autobusit, që punon në linjë ndërqytetëse, duhet të jenë të afishuar tarifat e biletave sipas destinacionit		Saktë
169	Brenda autobusit, që punon në linjë ndërqytetëse, duhet të jetë afishuar licenca e transportit		Gabim
170	Brenda autobusit, që punon në linjë ndërqytetëse, mund të afishohen edhe materiale me karakter pornografik		Gabim
171	Brenda autobusit, që punon në linjë ndërqytetëse, duhet të afishohen vetëm masat administrative ndaj udhëtarëve që nuk pajisen me biletë		Gabim
172	Transporti me autobus shtëpi-punë i punonjësve përfshihet në shërbimet e rregullta të specializuara		Saktë
173	Transporti me autobus shtëpi-institucion shkollor i nxënësve dhe studentëve, përfshihet në shërbimet e rregullta të specializuara		Saktë
174	Autobusi, që kryen transport ndërkombëtar të udhëtarëve, duhet të plotësojë kriteret e komoditetit të udhëtimit, sipas akteve në fuqi		Saktë
175	Autobusi, që kryen transport ndërkombëtar të udhëtarëve, duhet të jetë i pajisur me certifikatën e kontrollit teknik		Saktë
176	Autobusi, që kryen transport ndërkombëtar të udhëtarëve, duhet të jetë i pajisur me akt-vlerësimin për plotësimin e kushteve të tij		Saktë
177	Autobusi, që kryen transport ndërkombëtar të udhëtarëve, duhet të ketë një vjetërsi prodhimi jo më shumë se 15 vjet		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
178	Autobusi që kryen transport ndërkombëtar të udhëtarëve, mjafton që të plotësojë kushtet e komoditetit për udhëtarët, pavarësisht gjendjes teknike të tij		Gabim
179	Autobusi që kryen transport ndërkombëtar të udhëtarëve, nuk pajiset me certifikatën e kontrollit teknik		Gabim
180	Autobusi që shërben për transportin e udhëtarëve, duhet të ketë pamje të jashtme dhe të brendshme estetike		Saktë
181	Autobusi që shërben për transportin e udhëtarëve, duhet të sigurojë hermeticitetin e nevojshëm nga faktorët e jashtëm		Saktë
182	Autobusi që shërben për transportin e udhëtarëve, duhet të ketë ndriçim të brendshëm të mjaftueshëm, sistem ventilimi dhe ngrohje		Saktë
183	Autobusi që shërben për transportin e udhëtarëve, në linja ndërkombëtare, veç të tjerash, duhet të ketë kondicioner dhe qendër zëri		Saktë
184	Autobusi që shërben për transportin e udhëtarëve, në linja interurbane duhet të ketë brenda vende për bagazhe të lehta		Saktë
185	Autobusi që shërben për transportin e udhëtarëve, mjafton që të ketë xhamat origjinal edhe pse dritaret mund të mos funksionojnë		Gabim
186	Autobusi që shërben për transportin e udhëtarëve, në ambientet e brendshme nuk ka vende për të vënë bagazhe të lehta		Gabim
187	Autobusi që shërben për transportin e udhëtarëve, duhet të pajiset me dokument akt-vlerësimi për plotësimin e kushteve, çdo 6 muaj nga DPSHTRR		Gabim
188	Autobusi që shërben për transportin e udhëtarëve, mjafton të ketë sedilje komode		Gabim
189	Në transportin e udhëtarëve, autobusi duhet të niset në orarin e caktuar në biletë		Saktë
190	Në transportin e udhëtarëve, në autobusët qytetës ka vende ulje për fëmijë, gra shtatzëna dhe të moshuar		Saktë
191	Në transportin ndërkombëtarë, çdo udhëtar duhet të ulet në vendin e caktuar në biletë		Saktë
192	Në transportin e udhëtarëve, lejohet që në ambientet e brendshme të autobusit të vendosen sende edhe pse mund të pengojnë qarkullimin e lirë të udhëtarëve		Gabim
193	Në transportin e udhëtarëve, lejohet pirja e duhanit apo biseda me drejtuesin e mjetit		Gabim
194	Në transportin e udhëtarëve, lejohet qëndrimi në këmbë si dhe transporti i udhëtarëve mbi numrin e vendeve të shënuar në leje qarkullimi		Gabim
195	Në transportin e udhëtarëve, në pamjen ballore të autobusit shënohet gjatësia e tij		Gabim
196	Në transportin e udhëtarëve, sedilja e drejtuesit të autobusit nuk është e nevojshme të ndahet me parapet nga sediljet që vijnë prapa		Gabim
197	Mjetet që përdoren në veprimtarinë e transportit të udhëtarëve në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të kenë kaluar kontrollin teknik		Saktë
198	Mjetet që përdoren në veprimtarinë e transportit të udhëtarëve në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë kushtet që lidhen me sigurinë e udhëtarëve dhe komoditetin e udhëtimit		Saktë
199	Transportuesit që kryejnë veprimtari transporti në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të pajisë drejtuesin e mjetit me të gjitha dokumentet e nevojshme		Saktë
200	Një ndër dokumentet që duhet të ketë drejtuesi i autobusit në qarkullim është akt-vlerësimin për plotësimin e kushteve të autobusit që lëshohet çdo vit nga DPSHTRR		Saktë



**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
201	Drejtuesi i autobusit në qarkullim duhet të ketë dhe dokumentin e lëshuar nga autoriteti kompetent sipas llojit të shërbimit (licencë, libër udhëtimi, autorizim apo autorizim bilateral)		Saktë
202	Një ndër dokumentet që duhet të ketë drejtuesi i autobusit në qarkullim është kontrata (polica) e sigurimit të detyruar		Saktë
203	Një ndër dokumentet që duhet të ketë drejtuesi i autobusit në qarkullim është vetëm certifikata e aftësisë profesionale (CAP)		Gabim
204	Një ndër dokumentet që duhet të ketë drejtuesi i autobusit në qarkullim është dokumenti i blerjes së autobusit		Gabim
205	Një ndër dokumentet që duhet të ketë drejtuesi i autobusit në qarkullim është vetëm leja e qarkullimit të mjetit		Gabim
206	Marrëdhënia kontraktore, në transportin rrugor të udhëtarëve përfundon, kur udhëtari zbret nga mjete i transportit dhe janë kryer të gjitha veprimet e dorëzimit të çdo bagazhi		Saktë
207	Bileta e udhëtimit ka edhe kundër biletën fiskale		Saktë
208	Bileta e udhëtimit identifikon ndërmarrjen e transportit		Saktë
209	Bileta e udhëtimit mund të shitet nga transportuesi ose agjencia e kontraktuar prej tij		Saktë
210	Bileta e udhëtimit duhet të ketë të shënuar çmimin		Saktë
211	Bileta e udhëtimit duhet të ketë të shënuar periudhën e vlefshmërisë		Saktë
212	Bileta e udhëtimit nuk është e besueshme, nëse nuk janë shkruar kushtet e përgjithshme të transportit, në të		Gabim
213	Bileta e udhëtimit ka vlerë, deri në momentin që niset autobusi		Gabim
214	Bileta e udhëtimit duhet të ketë edhe kohëzgjatjen e udhëtimit		Gabim
215	Bileta e udhëtimit duhet të ketë të shënuar edhe targën e mjetit		Gabim
216	Ne kontratën e transportit rrugor të udhëtarëve, objekt është transportimi i një apo disa personave nga një vend në një tjetër		Saktë
217	Ne kontratën e transportit rrugor të udhëtarëve, subjekte janë udhëtari dhe agjencia e transportit		Saktë
218	Ne kontratën e transportit rrugor të udhëtarëve, si rregull, kontrata lidhet me dhënien e një biletë udhëtimi, kundrejt pagesës së një tarife të caktuar		Saktë
219	Për zbatimin e rregullave të sigurisë rrugore, autobusi duhet të ndalojë vetëm në stacionet e përcaktuara, me përjashtim të rasteve urgjente		Saktë
220	Për të qarkulluar me autobus jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kërkohet një Pasaportë e vlefshme		Saktë
221	Për të qarkulluar me autobus jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kërkohet një kontratë sigurimi ndërkombëtar (Karton jeshil)		Saktë
222	Nuk është detyrim i agjencisë së transportit, në linjë të rregullt me autobus, afishimi brenda autobusit i stacioneve të qëndrimit		Gabim
223	Mjetet e destinuar për transport njerëzish të kategorisë ndërkombëtare M1, janë Autobusë që kanë jo më shumë se 8 ndenjëse (pa përfshirë drejtuesin e mjetit)		Gabim
224	Mjetet e destinuar për transport njerëzish të kategorisë ndërkombëtare M2 janë Autobusë , që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 ton		Saktë
225	Mjetet e destinuar për transport njerëzish të kategorisë ndërkombëtare M3 janë Autobusë, që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 ton		Saktë
226	Mjetet e destinuar për transport njerëzish të kategorisë ndërkombëtare M2 janë Autobusë që kanë jo më shumë se 8 ndenjëse (pa përfshirë drejtuesin e mjetit ) dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 ton		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
227	Mjetet e destinuar për transport njerëzish të kategorisë ndërkombëtare M2 janë Autobusë, që kanë më shumë jo më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 ton		Gabim
228	Autobusë, që i përkasin kategorisë ndërkombëtare M3, janë mjetet që kanë jo më shumë se 8 ndenjëse (pa përfshirë drejtuesin e mjetit) me ngarkesë deri 5 ton		Gabim
229	Në mjetet e kategorisë ndërkombëtare M bëjnë pjesë dhe rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot)		Gabim
230	Autobusë, që i përkasin kategorisë ndërkombëtare M4, janë mjetet që kanë jo më shumë se 8 ndenjëse (pa përfshirë drejtuesin e mjetit) me ngarkesë deri 5 ton		Gabim
231	Plotësimi i kushteve në komoditetin e mjeteve në transportin e udhëtarëve, verifikohet nga komisioni i DPSHTRR-së		Saktë
232	Pajisja e autobusit me akt vlerësimin për plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve, nuk është kusht për licencim		Gabim
233	Akt vlerësimi për kushtet e komoditetit të udhëtarëve, i lëshuar nga DPSHTRR, ka afat vlefshmërie 3 vjeçar		Gabim
234	Stacionet e linjave ndërqytetëse mund të përcaktohen nga drejtuesi i autobusit, në varësi të kërkesës së udhëtarëve		Gabim
235	Certifikata e transportit për autobusët e shërbimit qytetës dhe rrethqytetës është pa afat vlefshmërie		Gabim
236	Nëse certifikata e transportit të mjetit "autobus" humbet ose është vjedhur, subjekti informon menjëherë zyrtarisht autoritetin e licencimit		Saktë
237	Kur certifikata e transportit të autobusit bëhet e palexueshme ose dëmtohet, ajo zëvendësohet nga autoriteti që e ka lëshuar		Saktë
238	Me Udhëzim të Ministrit përcaktohen dhe itineraret e udhëtimit si dhe stacionet e linjave të miratuara		Saktë
239	Certifikata e operimit të mjetit nuk është e domosdoshme në rastin e transportit rrethqytetës		Gabim
240	Drejtuesi i autobusit, mund të kryejë transport udhëtarësh në linja të ndryshme rrethqytetëse, mjafton të jetë i licencuar në një linjë të caktuar		Gabim
241	Ndëshkohet me masa administrative cilido që përdor në shërbimin në linjë për transport udhëtarësh një mjet, që nuk është caktuar për një shërbim të tillë		Saktë
242	Paneli plotësues mund të tregojë kategorinë e automjetit për të cilën zbatohet ndalimi	127	Gabim
243	Paneli plotësues në figurë mund të kombinohet me një sinjal detyrimi	127	Saktë
244	Paneli plotësues në figurë mund të kombinohet me një sinjal ndalimi	127	Saktë
245	Paneli plotësues në figurë nuk zbatohet për autobusët e linjave ndërqytetëse	127	Gabim
246	Në prani të sinjalit të treguar, reduktuesi mund të aktivizohet, nëse automjeti është i pajisur me të	17	Saktë
247	Në prani të sinjalit të treguar, mund të jetë e nevojshme të ç 'aktivizoni sistemin shtesë ABS të frenimit, nëse automjeti është i pajisur me të	17	Gabim
248	Në prani të sinjalit të treguar, duhet të ngadalësoni shpejtësinë duke përdorur frenat për të mos dëmtuar kutinë e shpejtësisë	17	Gabim
249	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesi duhet të drejtoni me vëmendje të veçantë për të parandaluar që frenat, të mbinxehen	17	Saktë
250	Në prani të sinjalit të treguar është e nevojshme të moderoni shpejtësinë në mënyrë që të mos përkeqësoni komoditetin e njerëzve të transportuar	2	Saktë
251	Sinjali i treguar ndalon transitin e autobusëve të artikuluar	2	Gabim
252	Sinjali i treguar imponon një kufi shpejtësie prej 30 km / orë	2	Gabim
253	Kur është e ndezur vija vertikale e bardhë poshtë, semafori në figurë detyron automjetet në shërbim të linjës për transportin e njerëzve të ndalojnë	156	Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
254	Kur është e ndezur vija horizontale e bardhë sipër, semafori në figurë detyron automjetet në shërbim të linjës për transportin e njerëzve të ndalojnë	156	Saktë
255	Semafori në figurë, me trekëndëshin e verdhë të ndezur, paralajmëron për punime në proces në rrugë	156	Gabim
256	Semafori në figurë është i vlefshëm për automjetet me targa ushtarake	156	Gabim
257	Semafori në figurë rregullon një kalim në nivel pa barriera	156	Gabim
258	Semafori në figurë rregullon qarkullimin e automjeteve në shërbim të linjës për transportin e njerëzve	156	Saktë
259	Semafori në figurë rregullon transitin në kalatat për hipjen në tragete	156	Gabim
260	Semafori në figurë mund të ketë gjithmonë të ndezur dritën vertikale të bardhë	156	Saktë
261	Semafori në figurë mund të ketë gjithmonë të ndezur dritën horizontale të bardhë	156	Saktë
262	Semafori në figurë njofton punime në proces	156	Gabim
263	Semafori në figurë tregon shkëmbimet e mundshme të shinave të tramvajit	156	Gabim
264	Semafori në figurë është i vlefshëm vetëm për automjetet që lëvizin në binarë (tramvajet, trenat)	156	Gabim
265	Sinjali i treguar në figurë tregon një semafor për automjetet e transportit publik	156	Saktë
266	Në zonat e banuara, sinjali i treguar është në fuqi nga ora 8.00 deri në 20.00	78	Gabim
267	Sinjali në figurë, i integruar me një panel të veçantë, mund të ndalojë qarkullimin e njëkohshëm të disa automjeteve	78	Saktë
268	Sinjali në figurë, ndalon qarkullimin e automjeteve që kanë një masë efektive më të madhe se ajo e treguar	78	Gabim
269	Sinjali në figurë, ndalon qarkullimin e të gjithë automjeteve me një masë totale të ngarkuar që tejkalon 7 tonë, pavarësisht nga masa e tyre në kohën e qarkullimit	78	Gabim
270	Sinjali i treguar është i vlefshëm edhe për kamionët që transportojnë ushqime	78	Saktë
271	Sinjali i treguar i referohet peshës së automjetit në kohën e qarkullimit	78	Saktë
272	Zigzagët e verdha, të sinjalistikës në figurë, tregojnë zonën për hyrjen e autobusit në vendqëndrim dhe daljen e tij nga vendqëndrimi	546	Saktë
273	Sinjali horizontal në figurë ndalon pushimin, por jo ndalimin, edhe në pjesët e rrugës të identifikuara nga shiriti i verdhë zig- zag	546	Saktë
274	Sinjalistika në figurë ndalon kalimin e kamionëve në zonën e kufizuar	546	Gabim
275	Sinjalistika në figurë mund të bëhet edhe me vija blu për autobusët e linjave interurbane	546	Gabim
276	Sinjalistika në figurë nuk lejojnë pushimin e mjeteve në zonën e shënuar me vijë të verdhë zig - zag	546	Gabim
277	Sinjalistika në figurë kufizon zonën ku është i ndaluar kalimi i autoveturave	546	Gabim
278	Sinjalistika në figurë tregon një hapësirë të rezervuar edhe për taksitë	546	Gabim
279	Sinjalistika në figurë tregon një hapësirë për ndalimin e autobusëve të artikuluar në shërbimin publik	546	Saktë
280	Sinjalistika në figurë tregon një zonë për ndalimin e autobusit në linjën e shërbimit publik	546	Saktë
281	Sinjalistika në figurë tregon hapësirën për ndalimin e autobusit dhe filobusit në shërbimin publik	546	Saktë
282	Sinjalistika në figurë kufizon hapësirën e rezervuar për pushimin e autobusëve	546	Gabim
283	Në prani të sinjalit të treguar, shoferi i një autobusi të artikuluar mund të kalojë i pari sepse ai ka përparësi ndaj automjeteve me masë më të vogël	45	Gabim
284	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesi i një autobusi të artikuluar, duhet të shmang përballjen me automjete të tjera brenda zonës së ngushtuar	45	Saktë
285	Sinjali në figurë të detyron tu japësh përparësi mjeteve, që vijnë nga kahu i kundërt	45	Saktë
286	Në prani të sinjalit në figurë duhet të kufizojmë shpejtësinë	45	Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
287	Sinjali në figurë tregon një pjesë rruge të ngushtë, që lejon kalimin vetëm për një rresht mjetesh	45	Saktë
288	Në prani të sinjali të treguar, drejtuesi i një autobusi, duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë që të mos godasë me gurët e thërrmuar në rrugë këmbësorët	23	Gabim
289	Në prani të sinjali të treguar, drejtuesi i një autobusi, duhet të jetë i kujdesshëm që të mos i afrohet shumë bankinës sepse mund të shembet	23	Saktë
290	Në prani të sinjali të treguar, drejtuesi i një autobusi, duhet të jetë i kujdesshëm që të mos i afrohet shumë bankinës sepse duke drejtuar një automjet me një qendër graviteti të lartë, ai mund të rrezikojë përmbysjen	23	Saktë
291	Në prani të sinjalit të treguar, automjetet për transportin e mallrave, me një masë totale të ngarkuar që tejkalon 3.5 tonë, mund të parakalojnë një mjet me motor me dy rrota, nëse nuk kalojnë vijën gjatësor të vazhdueshme	60	Gabim
292	Në prani të sinjalit të treguar, automjetet për transportin e mallrave, me një masë totale me një ngarkesë të plotë prej më shumë se 3.5 tonë, mund të parakalojnë autokampet me një masë totale me një ngarkesë të plotë më pak se 3.5 ton	60	Gabim
293	Në prani të sinjalit të treguar, automjetet për transportin e mallrave, me një masë totale në ngarkesë të plotë që tejkalon 3.5 tonë, nuk mund të kalojnë biçikletat, edhe nëse manovrat mund të kryhet brenda gjysmë korsie	60	Gabim
294	Në prani të sinjalit të treguar, automjetet me një masë bruto që tejkalojnë 3.5 tonë që mbartin mallra nuk mund të parakalojnë motoçikletat	60	Saktë
295	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesit e autobusëve me një masë totale të ngarkuar që tejkalon 3.5 tonë nuk mund të parakalojnë automjete të tjera motorike	60	Gabim
296	Në mungesë të ndalimeve të tjera, në prani të sinjalit të treguar, drejtuesit e kamionëve me një masë totale me ngarkesë të plotë që tejkalon 3.5 tonë, mund të parakalojnë automjetet pa motor madje, nëse nuk ka një vijë gjatësore të pandërprerë	60	Gabim
297	Në mungesë të ndalimeve të tjera, në prani të sinjalit të treguar, drejtuesit e kamionëve me një masë totale të ngarkuar plotësisht deri në 3.5 tonë, mund të kalojnë automjete të tjera motorike, por vetëm nëse manovra mund të kryhet brenda gjysmës së karrexhtës	60	Gabim
298	Në mungesë të ndalimeve të tjera, në prani të sinjalit të treguar, autobusët, edhe nëse me një masë ngarkese të plotë që tejkalon 3.5 tonë, mund të parakalojnë si automjetet pa motor dhe ato me motor	60	Saktë
299	Në mungesë të ndalimeve të tjera, në prani të sinjalit të treguar, autobusët, edhe nëse me një masë plotësisht të ngarkuar që tejkalon 3.5 tonë, mund të parakalojnë kamionët e artikulluar	60	Saktë
300	Në mungesë të ndalimeve të tjera, sinjali i treguar lejon që kamionët, me një masë bruto të automjetit deri në 3.5 tonë, të parakalojnë automjetet motorike	60	Saktë
301	Në mungesë të ndalimeve të tjera, sinjali i treguar lejon që kamionët, me një masë të plotë ngarkese që tejkalon 3.5 tonë, të parakalojnë automjetet pa motorë, nëse manovra mund të kryhet brenda gjysmë korsisë	60	Saktë
302	Sinjali i treguar i referohet drejtuesve të autobusëve të çdo mase	60	Gabim
303	Sinjali i treguar, i integruar me një panel që tregon 5 ton, ndalon qarkullimin e automjeteve që transportojnë mallra nëse masa totale e tyre e ngarkuar tejkalon 5 ton	60	Gabim
304	Sinjali i treguar me panel shtesë që tregon 5 ton, ndalon automjetet që mbajnë mallra, me një masë totale në ngarkesë të plotë që tejkalon 5 tonë, të parakalojnë automjetet motorike	60	Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
305	Sinjali i treguar ndalon automjetet për transport specifik, me një masë totale në ngarkesë të plotë që tejkalojnë 3.5 tonë dhe nuk janë të destinuara për transportin e njerëzve, të parakalojnë automjetet motorike	60	Saktë
306	Sinjali i treguar ndalon që automjetet me një peshë bruto të që tejkalojnë 3.5 tonë, që nuk janë të destinuara për transportin e personave, të parakalojnë automjetet motorike	60	Saktë
307	Sinjali i treguar paralajmëron që automjetet me një masë bruto të automjeteve që tejkalojnë 3.5 tonë që transportojnë njerëz të mos parakalojnë automjete motorike	60	Gabim
308	Sinjali i treguar nuk vendos ndalime për drejtuesit e autobusëve, edhe nëse ata drejtojnë automjete me një masë totale të ngarkuar plotësisht me 3.5 tonë	60	Saktë
309	Sinjali i treguar lejon që automjetet për transportin e mallrave, me një masë totale të ngarkuar që tejkalojnë 3.5 tonë, të parakalojnë makinat	60	Gabim
310	Sinjali i treguar lejon që automjetet me qëllim të veçantë, me një masë bruto automjeti që tejkalojnë 3.5 tonë, të parakalojnë automjetet motorike	60	Gabim
311	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesit e autobusëve duhet të ulin ndjeshëm shpejtësinë e tyre në mënyrë që të mos përkeqësojnë komoditetin e udhëtimit të pasagjerëve	1	Saktë
312	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesit e autobusëve duhet të zvogëlojnë shpejtësinë e tyre në mënyrë të konsiderueshme për të shmangur përplasjet midis pasagjerëve, veçanërisht nëse ata po udhëtojnë në këmbë	1	Saktë
313	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesit e autobusëve duhet të zvogëlojnë shpejtësinë e tyre në mënyrë të konsiderueshme për të shmangur lëkundjet e tepruara tek udhëtarët	1	Saktë
314	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesit e autobusëve duhet të zvogëlojnë shpejtësinë e tyre në mënyrë të konsiderueshme për të shmangur rënien e pasagjerëve, veçanërisht nëse ata po udhëtojnë në këmbë	1	Saktë
315	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesit e autobusëve duhet të japin një njoftim përmes mikrofonit për të gjithë pasagjerët për rrezikun e afërt	1	Gabim
316	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesit e autobusëve duhet t'u kërkojnë pasagjerëve të zgjidhin rripat e sigurimit për të parandaluar ndonjë goditje nga shkaktimi i traumës në bark ose gjoks	1	Gabim
317	Në prani të shenjës së treguar, drejtuesit e autobusëve duhet të përshpejtojnë për të kaluar sa më shpejt pjesën e rrugës	1	Gabim
318	Në prani të sinjalit të treguar, duhet të përshpejtoni në ngushtim për të kaluar shpejt seksionin me një drejtim	53	Gabim
319	Në prani të sinjalit të treguar, drejtuesi, duhet të jetë shumë i kujdesshëm për të siguruar që automjetet që vijnë nga drejtimi i kundërt janë të gatshëm t'i japin përparësi	53	Saktë
320	Në prani të sinjalit të treguar, është e nevojshme të moderoni shpejtësinë në mënyrë që të mos rrezikoni që pasagjerët në këmbë mund të bien ose të përplasen me njëri-tjetrin	4	Saktë
321	Në prani të sinjalit të treguar, është e nevojshme të moderoni shpejtësinë në mënyrë që të mos rrezikoni komoditetin e udhëtimit të njerëzve të transportuar	4	Saktë
322	Në prani të sinjalit të treguar, të gjithë udhëtarët në këmbë duhet të ulen	4	Gabim
323	Sinjali i treguar paralajmëron një seri kthesash të rrezikshme	4	Gabim
324	Sinjali i treguar nuk vendoset kurrë në autostrada	4	Gabim
325	Në prani të sinjalit të treguar, është e nevojshme të moderoni shpejtësinë në mënyrë që të mos rrezikoni që pasagjerët në këmbë mund të bien ose të përplasen me njëri-tjetrin	6	Saktë
326	Në prani të sinjalit të treguar, është e nevojshme të moderoni shpejtësinë në mënyrë që të mos rrezikoni komoditetin e udhëtimit të njerëzve të transportuar	6	Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
327	Në prani të sinjalit të treguar, të gjithë udhëtarët në këmbë duhet të ulen	6	Gabim
328	Sinjali i treguar paralajmëron një kthesë të rrezikshme në të majtë	6	Gabim
329	Sinjali i treguar nuk vendoset kurrë në rrugë malore	6	Gabim
330	Sinjali i treguar imponon një kufi shpejtësie prej 70 km / orë për autobusët me një masë totale në ngarkesë të plotë që tejkalon 3.5 tonë	6	Gabim
331	Në prani të sinjalit të treguar është i ndaluar qarkullimi i autobusëve me masë maksimale me ngarkesë deri në 6.5 tonë	69	Gabim
332	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet transiti i automjeteve me një masë maksimale me ngarkesë deri në 5 tonë	69	Saktë
333	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet transiti i automjeteve për përdorim të veçantë me një masë që tejkalon 6.5 tonë	69	Gabim
334	Në prani të sinjalit të treguar, automjetet me një masë pa ngarkesë, prej 7.5 tonë, lejohen të qarkullojnë	69	Gabim
335	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i autobusëve	69	Saktë
336	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e autobusëve me një masë totale që tejkalon 10 ton	69	Gabim
337	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e automjeteve me një masë që tejkalon 6.5 tonë të destinuara për transportin e njerëzve	69	Gabim
338	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet transiti i një automjeti që tërheq një rimorkio	70	Saktë
339	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i një autobusi të artikuluar, nëse qarkullon bosh	70	Saktë
340	Në prani të sinjalit të treguar, nuk lejohet qarkullimi i një autobusi të artikuluar	70	Gabim
341	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i një autobusi që tërheq një rimorkio për transportin e pajisjeve sportive me masë maksimale të autorizuar deri në 750 kg	70	Saktë
342	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e automjeteve që tërheqin një rimorkio	70	Saktë
343	Sinjali i treguar është i vlefshëm vetëm për automjetet që përdoren për transportin e mallrave	70	Gabim
344	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i një autobusi të gjatë 9 metra që tërheq një rimorkio të lehtë, dhe nëse bashkohen ato tejkalojnë gjatësinë e 10 metrave	77	Gabim
345	Në prani të shenjës së treguar, qarkullimi lejohet për të gjithë autobusët e artikuluar për transportin e njerëzve	77	Gabim
346	Sinjali i treguar është i vlefshëm edhe gjatë natës	77	Saktë
347	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e automjeteve më gjatë se sa tregohet	77	Saktë
348	Sinjali i treguar detyron një automjet të mbajë distance, të paktën 10 metra, nga automjeti përpara	77	Gabim
349	Sinjali i treguar duhet të respektohet vetëm nga drejtuesit e automjeteve që përdoren për transportin e mallrave	77	Gabim
350	Sinjali i treguar gjithashtu duhet të respektohet nga drejtuesit e komplekseve të automjeteve	77	Saktë
351	Shenja e treguar duhet të respektohet edhe nga drejtuesit e autobusëve	77	Saktë
352	Në prani të sinjalit të treguar, nuk lejohet qarkullimi i autobusëve me katër akse	79	Gabim
353	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e automjeteve që kanë një masë efektive për bosht më të madh se 2.5 tonë	79	Saktë
354	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e automjeteve që kanë një masë efektive më të madhe se ajo e treguar në boshtin më të ngarkuar	79	Saktë
355	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e kamionëve me një masë totale më të madhe se ajo e treguar	79	Saktë
356	Sinjali i treguar ndalon qarkullimin e të gjitha automjeteve me një masë totale të ngarkuar që tejkalon 2.5 tonë	79	Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
357	Sinjali i treguar është i vlefshëm vetëm për automjetet me rrota dyshe (dopio gomë)	79	Gabim
358	Sinjali i treguar i referohet masës që peshon në aks në momentin e qarkullimit	79	Saktë
359	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i autobusëve me një masë që i tejkalon 7 tonë	78	Gabim
360	Në prani të sinjalit të treguar, qarkullimi lejohet për automjetet, aksi më i ngarkuar i të cilave ka një masë më të madhe se ajo e treguar	78	Gabim
361	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i artikularëve	67	Gabim
362	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i autobusëve për transportin e nxënësve të shkollës	67	Gabim
363	Në prani të sinjalit së treguar, lejohet qarkullimi i kamionëve	67	Saktë
364	Në prani të sinjalit të treguar, lejohet qarkullimi i autobusëve turistikë	67	Gabim
365	Sinjali i treguar gjithashtu ndalon transitin e autobusëve me një masë të ngarkuar plotësisht prej më pak se 3.5 tonë	67	Saktë
366	Sinjali i treguar tregon një korsi të rezervuar për autobusët	67	Gabim
367	Sinjali i treguar mund të vendoset në një pjesë të rrugës ku nuk duhet, që shumë automjete të rënda, të kalojnë në të njëjtën kohë në një vepër arti (për shembull në një urë)	57	Saktë
368	Sinjali i treguar mund të vendoset në pjesët e rrugës ku parakalimi është i vështirë dhe ka shumë automjete të rënda	57	Saktë
369	Sinjali i treguar përcakton një kufi maksimal për numrin e automjeteve që mund të kalojnë në një vepër arti (për shembull në një urë)	57	Gabim
370	Sinjali i treguar është i vlefshëm për autoveturat dhe jo për autobusët ose automjetet me një peshë bruto të automjetit mbi 3.5 tonë	57	Gabim
371	Sinjali i treguar paraqet një zonë parkimi të ndaluar për autobusët	916	Saktë
372	Sinjali në figurë tregon se të gjitha automjetet, përveç autobusëve, mund të parkojnë	916	Saktë
373	Sinjali i treguar paraqet një zonë parkimi të rezervuar për autobusët	916	Gabim
374	Sinjali në figurë ndalon qëndrimin e autobusëve	918	Gabim
375	Sinjali në figurë ndalon kalimin e autobusëve	917	Gabim
376	Sinjali në figurë lejon kalimin vetëm për autobusët	917	Saktë
<b>TEMA IV : DOKUMENTET E MJETIT DHE QARKULLIMIT QË KËRKOHEN PËR TRANSPORTIN KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR TË UDHËTARËVE</b>			
377	Leja e qarkullimit është dokument që drejtuesi i mjetit duhet ta ketë me vete kur qarkullon me mjet		Saktë
378	Lejedrejtimi, e vlefshme për kategorinë përkatëse të mjetit, është dokumenti që drejtuesi i mjetit duhet ta ketë me vete kur qarkullon me mjet		Saktë
379	Certifikata e kontrollit teknik të mjetit është dokument që drejtuesi i mjetit duhet ta ketë me vete kur qarkullon me mjet		Saktë
380	Dokumenti i origjinës apo prejardhjes së mjetit është dokument që drejtuesi i mjetit duhet ta ketë me vete kur qarkullon me mjet		Gabim
381	Dokumenti i zhdoganimit të mjetit është dokument që drejtuesi i mjetit duhet ta ketë me vete kur qarkullon me mjet		Gabim
382	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohen marka, tipi dhe numri i identifikimit të mjetit		Saktë
383	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohen përmasat gabarite të tij		Saktë
384	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohet viti i prodhimit të tij		Saktë
385	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohet masa pa ngarkese e tij		Saktë
386	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohet masa maksimale e autorizuar		Saktë
387	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohen fuqia dhe cilindrata e motorit		Saktë
388	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohet numri i akseve		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
389	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohet emri i subjektit fizik ose juridik që ka mjetin në pronësi		Saktë
390	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohet destinacioni dhe përdorimi i tij		Saktë
391	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohet diametri i cilindrit të motorit		Gabim
392	Në lejen e qarkullimit të autobusit nuk shënohet kapaciteti i vendeve		Gabim
393	Në lejen e qarkullimit të autobusit shënohet pesha e motorit		Gabim
394	Cilido që qarkullon me një automjet të pa pajisur me leje qarkullimi ndëshkohet me masën administrative gjobë dhe i konfiskohet mjeti		Saktë
395	Kur qarkullohet me automjet të pa pajisur me leje qarkullimi, përveç drejtuesit, ndëshkohet me masë administrative gjobë edhe pronari i tij		Saktë
396	Kur qarkullohet me automjet të pa pajisur me leje qarkullimi zbatohet edhe masa administrative plotësuese e konfiskimit të mjetit		Saktë
397	Kur mjetit i janë bërë ndryshime konstruktive të lejuara, për t'i pasqyruar ato duhet të rinovohet leja e qarkullimit		Saktë
398	Ndryshime konstruktive mund të realizohen nga pronari i mjetit mjafton të reflektohen në lejen e qarkullimit		Gabim
399	Kur ndryshon pronësia e mjetit rrugor, duhet bërë edhe rinovimi i lejes së tij të qarkullimit		Saktë
400	Kur ndryshon adresa e vendbanimit e pronarit të mjetit duhet të bëhet rinovimi i lejes së qarkullimit të tij		Saktë
401	Rinovimi i lejes së qarkullimit të mjetit është i detyruar vetëm kur ndryshohet ngjyra e tij		Gabim
402	Vendbanimi i pronarit nuk shënohet në lejen e qarkullimit të mjetit, prandaj rinovimi i saj nuk është i nevojshëm, kur pronari ndryshon vendbanim		Gabim
403	Rinovimi i lejes së qarkullimit të mjetit është i detyruar të bëhet periodikisht çdo pesë vjet		Gabim
404	Kur leja e qarkullimit humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i saj brenda 24 orëve nga konstatimi, duhet të bëjë denoncim në organet e policisë		Saktë
405	Në rast se leja e qarkullimit humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i saj mund të kërkojë të pajiset me leje qarkullimi të përkohshme me afat për 30 ditë, mbi bazën e vërtetimit të denoncimit lëshuar nga policia		Saktë
406	Pas denoncimit në polici, zotëruesi i mjetit detyrohet të pajiset me leje qarkullimi të re mbas afatit kohor prej 60 ditëve		Gabim
407	Në rast se leja e qarkullimit humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i saj pas denoncimit në polici, pajiset menjëherë me leje qarkullimi të re, në zyrën përkatëse të Drejtorisë së Shërbimeve të Transportit Rrugor		Saktë
408	Në rast se leja e qarkullimit humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i saj duhet të bëjë denoncim në polici pas 7 ditëve		Gabim
409	Në rast se leja e qarkullimit humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i saj duhet të pajiset me targa të reja, automatikisht pas marrjes së vërtetimit të denoncimit në organet e policisë		Gabim
410	Në rast se leja e qarkullimit humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i saj duhet të pajiset me lejen e përkohshme të qarkullimit me afat 60 ditë		Gabim
411	Në rast se një nga targat humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i mjetit brenda 24 orëve nga konstatimi i faktit, duhet të bëjë denoncim në organet e policisë		Saktë
412	Në rast se një nga targat humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i mjetit pajiset nga zyra përkatëse e Drejtorisë së Shërbimeve të Transportit Rrugor me targë të përkohshme deri 15 ditë, pasi paraqet vërtetimin e denoncimit të lëshuar nga policia		Gabim



**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
413	Në rast se një nga targat humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i mjetit për mos gjetje të targës mbas denoncimit në organet e policisë, detyrohet të bëjë regjistrim të ri të mjetit		Saktë
414	Në rast se një nga targat humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i mjetit pajiset me të njëjtën targë		Gabim
415	Në rast se një nga targat humbet, vidhet ose shkatërrohet, zotëruesi i mjetit duhet të bëjë denoncim në polici pas 48 orëve		Gabim
416	Cilido që qarkullon me një mjet, që i është modifikuar shasia dhe nuk ka marrë miratimin pas kontrollit dhe provës pranë zyrës përkatëse të Drejtorisë së Shërbimeve të Transportit Rrugor, gjobitet dhe i hiqet leja e qarkullimit		Saktë
417	Cilido që qarkullon me mjet, të cilit i është falsifikuar numri i shasisë, ndëshkohet me gjobë, heqje të lejes së qarkullimit dhe bëhet ndalimi administrativ i mjetit		Saktë
418	Cilido që qarkullon me mjet, të cilit nuk i është kryer kontrolli teknik, gjobitet dhe i tërhiqet leja e qarkullimit deri në kryerjen e kontrollit teknik		Saktë
419	Leja e qarkullimit tërhiqet (merret) nga organet e kontrollit, kur ka ndryshuar pronari i mjetit dhe ky ndryshim nuk është pasqyruar në lejen e qarkullimit		Saktë
420	Leja e qarkullimit tërhiqet (merret) nga organet e kontrollit, kur qarkullohet me një mjet, kur drejtuesi është në gjendje të dehur		Gabim
421	Leja e qarkullimit tërhiqet (merret) nga organet e kontrollit, kur qarkullohet me një mjet, pa vendosur rripat e sigurimit		Gabim
422	Leja e qarkullimit tërhiqet (merret) nga organet e kontrollit, kur qarkullohet me mjet, pa kryer ndryshimet për vlefshmërinë e lejedrejtimit		Gabim
423	Për të bërë çregjistrimin përhershëm të mjetit, kur zotëruesi i tij kërkon ta nxjerr jashtë përdorimit, duhet që brenda 10 ditëve të bëjë kërkesën dhe të dorëzojë targat, lejen e qarkullimit dhe certifikatën e pronësisë pranë zyrës përkatëse të Drejtorisë së Shërbimeve të Transportit Rrugor		Saktë
424	Në rast të heqjes nga qarkullimi të mjetit që del jashtë përdorimit, zotëruesi i tij nuk ka detyrim të marrë dokument çregjistrimit të mjetit nga zyra përkatëse e Drejtorisë së Shërbimeve të Transportit Rrugor, për heqje të përhershme nga qarkullimi		Gabim
425	Për heqjen e përkohshme të mjetit nga qarkullimi, zotëruesi i tij duhet të bëjë kërkesë pranë zyrës përkatëse të Drejtorisë së Shërbimeve të Transportit Rrugor		Saktë
426	Për heqjen e përkohshme të mjetit nga qarkullimi, mjafton që zotëruesi i mjetit të sigurojë vendosjen e mjetit në një parking të autorizuar		Gabim
427	Cilido që vendos shkrime ose shenja, që pengojnë identifikimin e mjetit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë		Saktë
428	Cilido që qarkullon me një targë që nuk është e vetja ose është e falsifikuar, ndëshkohet me masë administrative me gjobë, tërheqje të targës dhe konfiskim mjeti		Saktë
429	Cilido që qarkullon me një targë që nuk është e vetja ose është e falsifikuar, ndëshkohet me masë administrative vetëm me gjobë		Gabim
430	Cilido që vendos shkrime ose shenja që pengojnë identifikimin e mjetit, ndëshkohet me masë administrative rivlerësim lejedrejtimi		Gabim
431	Cilido që qarkullon me mjet të pa pajisur me targa, ndëshkohet me masë administrative pezullim leje qarkullimi		Gabim
432	Dokumenti që provon mbajtjen e licencës dhe është i vlefshëm për të drejtën e operimit të një mjeti është certifikata për shërbime transporti		Saktë
433	Dokumenti që i jep të drejtë një mjeti vetëm për transportin e udhëtarëve për vete brenda dhe jashtë vendit quhet certifikatë për shërbime transporti		Saktë
434	Certifikata për shërbime transporti është dokument që mbahet në mjet dhe i përket vetëm mjetit, për të cilin është lëshuar		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
435	Certifikata për shërbime transporti është dokument që mbahet në mjet që u lëshohet vetëm mjeteve që kryejnë transporte udhëtarësh për nevojat e veta		Gabim
436	Certifikata për shërbime transporti është dokument që mbahet në mjet dhe nuk ka afat vlefshmërie		Gabim
437	Çdo autobus pajiset me Certifikatë për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve, pas plotësimit të kushteve sipas legjislacionit në fuqi		Saktë
438	Për kryerjen e shërbimeve të rregullta të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit, si dokumente objekt kontrolli për operimin në rrugë janë licenca dhe certifikata e operimit të mjetit		Saktë
439	Në rastin e shërbimeve të rregullta të specializuara, si dokument kontrolli në rrugë janë: licenca, certifikata përkatëse e mjetit si dhe kontrata ndërmjet subjektit dhe organizatorit të transportit dhe lista e udhëtarëve		Saktë
440	Drejtuesi i autobusit duhet të mbajë në mjet kopje të njehsuara me origjinalin të licencës dhe certifikatën origjinale		Saktë
441	Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike (TPL) dhe certifikata e kolaudimit të tahografit janë dokumente, që drejtuesi i mjetit për transportin e udhëtarëve duhet të mbajë në mjet		Saktë
442	Drejtuesi i autobusit për transport udhëtarësh (kombëtar dhe ndërkombëtar) përveç rasteve të parashikuara në ligj ka detyrimin të jetë i pajisur me Certifikatën e Aftësisë Profesionale		Saktë
443	Drejtuesi i autobusit duhet të jetë i pajisur me Certifikatën e Aftësisë Profesionale (CAP), vetëm në rastin e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve		Gabim
444	Dokumente të domosdoshme për drejtuesin e autobusit janë leja e drejtimit me kategorinë përkatëse dhe certifikata e aftësisë profesionale.		Saktë
445	Për te rinovuar Certifikatën e Aftësisë Profesionale (CAP) duhet te ndiqet një kurs trajnimi periodik		Saktë
446	Certifikata e Aftësisë Profesionale (CAP) duhet rinovuar çdo 5 vjet		Saktë
447	Për të drejtuar një autobus, drejtuesi duhet të jetë pajisur certifikatën e aftësisë profesionale (CAP) për mallra		Gabim
448	Për të drejtuar një autobus, drejtuesi duhet të jetë pajisur certifikatë profesionale ATP, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor, sipas vendit të banimit		Gabim
449	Drejtuesi i një autobusi, me kërkesën e organeve të kontrollit rrugor, duhet të paraqesë certifikatën e aftësisë profesionale (CAP) të vlefshme		Saktë
450	Leja e drejtimit për mjetet e kategorisë M2 lëshohet nga Prefekti i Qarkut		Gabim
451	Karta e tahografit për kompanitë lëshohet nga Dhoma e Tregtisë		Gabim
452	Për të rinovuar Certifikatën e Aftësisë Profesionale (CAP), aplikanti duhet të paraqesë vetëm certifikatën mjekësore		Gabim
453	Një autobus, për të qarkulluar brenda vendit , duhet të ketë sigurimin e detyrueshëm të automjeteve rrugore (TPL) të vlefshme		Saktë
454	Për të drejtuar një automjet jashtë vendit, kërkohet certifikata ndërkombëtare e sigurimit motorik (kartoni jeshil)		Saktë
455	Kartat e tahografit lëshohen nga Drejtoria Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, sipas territorit të vendbanimit të aplikantit		Saktë
456	Karta e tahografit të drejtuesit të mjetit nuk ka afat vlefshmërie		Gabim
457	Karta e tahografit skadon, kur leja e drejtimit humbet vlefshmërinë		Gabim
458	Karta e tahografit të drejtuesit përmban dhe numrin e lejedrejtimit		Saktë
459	Një autobus, që operon shërbime të rregullta me vendet e BE-së duhet të ketë në bord listën e udhëtarëve		Saktë
460	Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve për shërbime të rastit, Itinerari kryesor duhet të shënohet në fletën e udhëtimit		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
461	Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve për shërbime të rastit fleta e udhëtimit duhet të përmbajë datën e nisjes dhe mbarimit të shërbimit.		Saktë
462	Një autobus që operon shërbime të rregullta në territorin e vendeve të BE-së duhet të ketë në bord originalin ose një kopje të noterizuar të autorizimit të lëshuar nga shteti, në territorin e të cilit ndodhet pika e nisjes		Saktë
463	Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve për shërbime të rastit, emri i kompanisë duhet të jetë i shënuar në fletën e udhëtimit		Saktë
464	Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve për shërbime të rastit, autobusi duhet të ketë në bord fletën e udhëtimit, që tregon oraret dhe çmimet e shërbimit		Gabim
465	Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve për shërbime të rastit dokumenti i udhëtimit, duhet të jetë në bordin e autobusit dhe i paraqitet autoritetit kontrollues, me kërkesë të tij		Saktë
<b>TEMA V : SJELLIA NË RASTET E AKSIDENTEVE. NJOHJA E MASAVE QË DUHET TË MERREN PAS NJË AKSIDENTI OSE DUKURI TË NGJASHME, DUKE PËRFSHIRË VEPRIME EMERGJENTE SI EVAKUIMI I UDHËTARËVE DHE NJOHURITË BAZË PËR DHËNIEN E NDIHMES SE PARE</b>			
466	Në rast aksidenti rrugor me të plagosur, drejtuesi i mjetit duhet të njoftojë shërbimet e Policisë Rrugore për të vëzhguar rrethanat e ngjarjes		Saktë
467	Në rast aksidenti rrugor, drejtuesi i mjetit duhet të veprojë për të ruajtur gjendjen e vendit të aksidentit dhe gjurmët e tij, duke ruajtur sigurinë e qarkullimit		Saktë
468	Pas një aksidenti rrugor, automjetet e përfshira nuk duhet të lëvizin derisa të shpëtohet ndonjë person i plagosur dhe policia ka gjetur të gjithë elementët e dobishëm për rindërtimin e aksidentit		Saktë
469	Pas një aksidenti rrugor, automjetet e përfshira mund të lëvizin edhe nëse policia nuk ka përfunduar zbulimin e elementeve të dobishëm për rindërtimin e aksidentit, për sa kohë që ndonjë person i dëmtuar është shpëtuar		Gabim
470	Në rast aksidenti rrugor, kur ka vetëm dëme materiale, drejtuesi i mjetit duhet të shmangë pengimin e qarkullimit, aty ku është e mundur		Saktë
471	Në rast aksidenti rrugor, drejtuesi i mjetit duhet të japë emrin, adresën si dhe informacione të tjera të nevojshme për të aksidentuarit		Saktë
472	Cilido që nuk ka qenë në gjendje të shmangë rënien e materialeve të buta (si baltë, llaç, rërë, etj., ) duhet të devijojë trafikun ndërsa pret entin pronat të rrugës të ndërhyjë për të rivendosur kushtet optimale		Gabim
473	Cilido që nuk ka qenë në gjendje të parandalojë rënien ose përhapjen e materialeve të rrezikshme, ndër të tjera, duhet të kryejë sinjale manuale për të parandaluar qarkullimin e automjeteve në pjesën e rrugës që nuk ndalohet nga sinjali i lëvizshëm i rrezikut		Saktë
474	Cilido që nuk ka qenë në gjendje të shmangë rënien ose përhapjen e materialeve të lëngshme, të ndezshme ose të rrezikshme duhet, ndër të tjera, t'i heq ato ose të përhapë në rrugë, nëse është e mundur, rërë, tallash ose material tjetër i përshtatshëm për të rivendosur kapjen		Saktë
475	Cilido që nuk ka qenë në gjendje të shmangë rënien ose përhapjen e materialeve të lëngshme, të ndezshme ose ndryshe të rrezikshme duhet, ndër të tjera, të sinjalizojë paraprakisht zonën me sinjali i lëvizshëm të rrezikut të vendosur, nëse është e nevojshme, edhe në qendër të rrugës		Saktë
476	Si rregull, nuk mund të tërhiqni ose të tërhiqeni nga më shumë se një automjet		Saktë
477	Natën, trekëndëshi i lëvizshëm i rrezikut duhet të përdoret për të sinjalizuar automjetin e ndaluar, për shkak të prishjes, nëse nuk është i dukshëm nga të paktën 150 metra larg		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
478	Natën, kur mungojnë ose mungojnë ose janë të pamjaftueshme dritat e pasme të emergjencës, është e detyrueshme të para-sinjalizoni automjetin e palëvizshëm me sinjalin e lëvizshëm të rrezikut edhe në zonat e banuara		Gabim
479	Pas një aksidenti rrugor, drejtuesi duhet të përdorë gjithmonë sinjalin e palëvizshëm të rrezikut		Gabim
480	Pas një aksidenti rrugor, në rastet dhe në mënyrën e parashikuar nga Kodi Rrugor, drejtuesi duhet të përdorë sinjalin e lëvizshëm të rrezikut		Saktë
481	Pas një aksidenti rrugor, nëse automjeti i përfshirë krijon një rrezik ose pengesë, duhet të hiqet nga rruga sa më shpejt që të jetë e mundur		Saktë
482	Pas një aksidenti rrugor, nëse automjeti i përfshirë krijon rrezik ose pengesë, ai mund të lihet në rrugë deri në një orë pas ngjarjes		Gabim
483	Gjatë operacioneve të para-sinjalizimit me sinjalin e lëvizshëm të rrezikut, përdorimi i jelekëve fosforeshent është opsional		Gabim
484	Gjatë operacioneve të para-sinjalizimit me sinjalin e lëvizshëm të rrezikut, drejtuesi duhet të veshë jelekun e dukshmërisë së lartë edhe nëse është në korsitë e emergjencës ose në sheshet e qëndrimit.		Saktë
485	Gjatë operacioneve të tërheqjes në situata emergjente, lidhja midis dy automjeteve duhet të bëhet duke u lidhur me një kablo elektrike		Gabim
486	Kur tërhiqet në situata emergjente, lidhja midis dy automjeteve nuk duhet të jetë më e gjatë se 1 metër		Gabim
487	Gjatë operacioneve të para-sinjalizimit me sinjalin e lëvizshëm të rrezikut, drejtuesi nuk duhet të veshë jelekun e dukshmërisë së lartë edhe nëse është në korsitë e emergjencës ose në sheshet e qëndrimit		Gabim
488	Gjatë operacioneve të tërheqjes në situata emergjente, lidhja midis dy automjeteve mund të bëhet vetëm me kusht që automjeti tërheqës të jetë i pajisur me një ganxhë të miratuar për tërheqje		Gabim
489	Gjatë operacioneve të tërheqjes, automjeti i tërhequr duhet të ndezë dritën e pasme të mjegullës në mungesë të ndonjë sinjali tjetër të përshtatshëm		Gabim
490	Gjatë operacioneve të tërheqjes, automjeti i tërhequr duhet të mbajë ndezur dritat paralajmëruese të rrezikut		Saktë
491	Gjatë operacioneve të tërheqjes, nëse automjeti i tërhequr nuk mund të aktivizojë dritat e emergjencës, duhet të mbajë sinjalin e lëvizshëm të rrezikut, ose panelin për ngarkesat e dala të ekspozuara në anën që përballet me trafikun		Saktë
492	Drejtuesi, i përfshirë në një aksident rrugor me dëme materiale, i cili nuk ndalet dënohet me burgim		Gabim
493	Drejtuesi, i përfshirë në një aksident rrugor me dëmtime të personit, i cili nuk ndalet për të ofruar ndihmë personit, dënohet me burgim		Saktë
494	Jashtë zonave të banuara është e detyrueshme, edhe gjatë ditës, të sinjalizoni paraprakisht një ngarkesë që ka rënë aksidentalisht në rrugë me anë të sinjalit trekëndësh të lëvizshëm të rrezikut, kur ngarkesa nuk mund të shihet qartë 100 metra larg		Saktë
495	Jashtë zonave të banuara, edhe gjatë ditës, është opsionale të para-sinjalizoni një ngarkesë të rënë aksidentalisht në karrexhatë që nuk mund të shihet qartë 100 metra larg, për sa kohë që ngarkesa zë vetëm një korsi		Gabim
496	Jashtë zonave të banuara, natën, është e detyrueshme të sinjalizohet paraprakisht me sinjalin trekëndësh të lëvizshëm të rrezikut çdo ngarkesë e rënë aksidentalisht nga automjeti në rrugën që nuk mund të hiqet		Saktë
497	Jashtë zonave të banuara, natën, kur dritat e pozicionit ose dritat e emergjencës mungojnë ose janë të pamjaftueshme, është e këshillueshme, por jo e detyrueshme, të para-sinjalizoni automjetin e palëvizshëm në rrugë, me sinjalin trekëndësh të rrezikut		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
498	Drejtuesi duhet të veshë jelekun e dukshmërisë së lartë gjatë natës, edhe në zonat e banuara, nëse automjeti i tij ndalet në rrugë për shkak të prishjes		Gabim
499	Drejtuesi, në rast të një aksidenti rrugor që lidhet me sjelljen e tij, ka detyrimin të ndalojë dhe të sigurojë ndihmë e nevojshme për personat që kanë pësuar dëme		Saktë
500	Drejtuesi, në rast aksidenti për shkak të sjelljes së tij, është i detyruar të ndalet, por jo të ofrojë ndihmë		Gabim
501	Drejtuesi, në rast të një aksidenti rrugor që i atribuohet sjelljes së tij, ka detyrimin të ndalojë dhe të ofrojë ndihmë për ata që kanë pësuar dëmtime të personit		Saktë
502	Sinjali trekëndësh i lëvizshëm i rrezikut duhet të vendoset prapa automjetit ose pengesës që sinjalizohet, të paktën 50 metra larg		Saktë
503	Sinjali trekëndësh i lëvizshëm i rrezikut duhet të vendoset mbi ngarkesën e rënë aksidentalisht në rrugë		Gabim
504	Shenja trekëndore e rrezikshme e lëvizshme duhet të vendoset në karrexhatë të paktën një metër nga bordura e jashtme e karrexhatës		Saktë
505	Sinjali trekëndësh i lëvizshëm i rrezikut duhet të vendoset të paktën një metër nga vijat gjatësorë të mesit të karrexhatës		Gabim
506	Sinjali trekëndësh i lëvizshëm i rrezikut duhet të vendoset në karrexhatë në një mënyrë të tillë që të jetë i dukshëm në një distancë prej të paktën 100 metra nga automjetet që vijnë		Saktë
507	Sinjali trekëndësh i lëvizshëm i rrezikut duhet të vendoset në karrexhatë në mënyrë të tillë që të jetë i dukshëm në një distancë prej të paktën 50 metra nga automjetet që vijnë		Gabim
508	Sinjali trekëndësh i lëvizshëm i rrezikut duhet të vendoset në korsinë e zënë nga automjeti i palëvizshëm ose ngarkesa e rënë		Saktë
509	Sinjali trekëndësh i lëvizshëm i rrezikut është pjesë e pajisjeve të detyrueshme të automjeteve motorike		Saktë
510	Rimorkimi i një automjeti me defekt është i ndaluar në autostradë, përveç nëse tërheqja kryhet nga një automjet i autorizuar për ndihmë në rrugë		Saktë
511	Rimorkimi i një automjeti të dëmtuar nuk duhet domosdoshmërisht të raportohet tek enti pronar i rrugës		Gabim
512	Rimorkimi i një automjeti të dëmtuar mund të kryhet vetëm nëse automjeti tërheqës ka një fuqi të motorit më të madhe se ajo e automjetit të tërhequr		Gabim
513	Automjeti që tërheq një automjet tjetër me defekt duhet të jetë së paku 60% më i rëndë		Gabim
514	Në rast të defektit mekanik të automjetit në një tunel të autostradës, që sjell bllokimin e tij, duhet të aktivizohet sinjalizimi me dritat e emergjencës		Saktë
515	Në rast të defektit mekanik të automjetit në një tunel të autostradës, që sjell bllokimin e tij, duhet ti kërkohet ndihmë drejtuesve më të afërt		Gabim
516	Në rast të defektit mekanik të automjetit në një tunel të autostradës, automjeti duhet të ndalet në korsinë e emergjencës, nëse është e pranishme		Saktë
517	Në rast të defektit mekanik të automjetit që e bllokoi atë në një tunel të autostradës, është e nevojshme, nëse është e mundur, të çohet automjeti në një zonë parkimi		Saktë
518	Në rast të defektit mekanik të automjetit që e bllokoi atë në një tunel të autostradës, është e nevojshme, nëse është e mundur, të çohet automjeti në një zonë parkimi		Saktë
519	Në rast aksidenti në një tunel që bllokoi trafikun, motori duhet të fiket duke lënë çelësin e ndezjes të integruar		Saktë
520	Në rast të një aksidenti në një tunel, drejtuesit e tjerë duhet të paralajmërohen me anë të sinjalit akustik, borisë		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
521	Në rast aksidenti në tunel, shërbimet e urgjencës duhet të njoftohen shpejt		Saktë
522	Në rast të një aksidenti në tunel, është e nevojshme të ktheni mjetin prapa dhe të pastroni vendin e aksidentit		Gabim
523	Në rast të një aksidenti në tunel, ndihma e parë duhet t'i jepet çdo personi të dëmtuar		Saktë
524	Në rast aksidenti në tunel, ngarkesa duhet të shkarkohet menjëherë		Gabim
525	Në rast aksidenti në tunel, është e nevojshme të zbrisni dhe poziciononi bllokimet nën rrotat e automjetit tuaj		Saktë
526	Në rast aksidenti në tunel, nëse duhet të dilni nga automjeti, këshillohet të vishni jelekun reflektues		Saktë
527	Në rast të një aksidenti rrugor, ndërhyrja e autoriteteve duhet të kërkohet vetëm kur numri i personave të lënduar është mbi tre		Gabim
528	Në rast të një aksidenti rrugor, ndërhyrja e autoriteteve duhet të kërkohet kur nuk është e mundur të rivendoset qarkullimi normal		Saktë
529	Në rast të bllokimit të karrexhatës për shkak të defektit të automjetit, që nuk mund të lëvizet, drejtuesi duhet të raportojë rrezikun tek drejtuesit e tjerë		Saktë
530	Në rast të një bllokimi të karrexhatës për shkak të defektit të automjetit, drejtuesi duhet të jetë në gjendje të riparojë avarinë shpejt nëse është një automjet i rëndë		Gabim
531	Në rast të një bllokimi të karrexhatës për shkak të defektit të automjetit, drejtuesit nuk i kërkohet ta lëvizë atë ndërsa pret ndihmë, nëse ka pak trafik në rrugë		Gabim
532	Drejtuesi i mjetit duhet të dijë numrat e telefonit të urgjencës mjekësore, zjarrfikësve dhe shërbimeve të policisë rrugore dhe ti përdor ato në rast aksidenti		Saktë
533	Në rast aksidenti rrugor, drejtuesi i mjetit mund të largohet nga vendi i ngjarjes, pa lejen e policisë rrugore		Gabim
534	Në rast aksidenti rrugor, ku drejtuesi i mjetit është pjesë, mund të largohet nga vendi i ngjarjes kur gjykon se nuk është fajtor		Gabim
535	Në rast aksidenti rrugor, drejtuesi i mjetit mjafton që të kujtohet për pozicionin e saktë të automjeteve pas përplasjes		Gabim
536	Pas një aksidenti rrugor që ka vetëm dëme materialë duhet të vendoset trekëndëshi i rrezikut, si në rastet e parashikuara nga Kodi Rrugor		Saktë
537	Pas një aksidenti rrugor që ka vetëm dëme materialë duhet të vendoset mjeti, nëse është e mundur, të paktën përgjatë anës së djathtë të karrexhatës		Saktë
538	Pas një aksidenti rrugor që ka vetëm dëme materialë duhet të njoftohen organet përkatëse, në pamundësi të zhvendosjes së mjetit, dhe ti presim në vendin e ngjarjes		Saktë
539	Pas një aksidenti rrugor që ka vetëm dëme materialë duhet vendosur " trekëndëshi i rrezikut" në anën e prapme të mjetit, përpara se të largoheni		Gabim
540	Pas një aksidenti rrugor që ka vetëm dëme materialë duhet të mbulohet mjeti me një mbulesë plastike		Gabim
541	Pas një aksidenti rrugor që ka vetëm dëme materialë duhet që vetëm nëse është natë, të vendoset trekëndëshi i rrezikut në afërsi të mjetit		Gabim
542	Pas një aksidenti rrugor që ka vetëm dëme materialë duhet të vendoset menjëherë mjeti mbi trotuar		Gabim
543	Pas një aksidenti rrugor që ka vetëm dëme materialë duhet në çdo rast, të paraqesësh denoncimin në komisaratin e policisë më të afërt		Gabim
544	Pas një aksidenti rrugor që ka vetëm dëme materialë duhet të mos sinjalizohet mjeti i ndaluar me "trekëndësh rreziku"		Gabim
545	Në rast aksidenti, kur ka materiale të rrëshqitshme mbi karrexhatë, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
546	Në rast aksidenti, kur ka bllokim të karrexhatës, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë, veçanërisht kur aksidenti ka ndodhur në kthesë		Saktë
547	Në rast aksidenti, kur në rrugë ka të plagosur që nuk mund të lëvizin, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë		Saktë
548	Në rast aksidenti, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë, kur në karrexhatë mbeten pjesë të mjeteve të aksidentuara që pengojnë qarkullimin		Saktë
549	Në rast aksidenti, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë vetëm në rast se trafiku është i bllokuar për shkak të tij		Gabim
550	Në rast aksidenti, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë vetëm në rast se ai ka ndodhur në rrugë interurbane pa ndriçim		Gabim
551	Në rast aksidenti, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë duke i rënë pajisjes së sinjalizimit zanor me bori me intervale të rregullta kohe		Gabim
552	Në rast aksidenti, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë duke ndezur një zjarr në afërsi të mjetit të aksidentuar, nëse është errësirë		Gabim
553	Në rast aksidenti, u duhet sinjalizuar rreziku mjeteve që vijnë vetëm në rast se ai ka ndodhur natën, në një qendër të banuar të ndriçuar		Gabim
554	Të ndihmosh një të aksidentuar në rrugë është e detyrim ligjor dhe moral		Saktë
555	Të ndihmosh një të aksidentuar në rrugë është detyrimi i Kodi Penal i cili dënon mosdhënien e ndihmës		Saktë
556	Të ndihmosh një të aksidentuar në rrugë është e detyrueshme, sepse ndihma mund të kufizojë pasojat negative të aksidentit		Saktë
557	Të ndihmosh një të aksidentuar në rrugë duhet të tregosh kujdes të mos shkaktosh rreziqe për veten dhe të tjerët		Saktë
558	Të ndihmosh një të aksidentuar në rrugë nuk është e detyrueshme		Gabim
559	Të ndihmosh një të aksidentuar në rrugë është e detyrim vetëm nëse gjykohet aksident i rëndë		Gabim
560	Të ndihmosh një të aksidentuar në rrugë nuk është detyrim nëse do ti shmangesh përfshirjes në ngjarje		Gabim
561	Të ndihmosh një të aksidentuar në rrugë është i detyrim vetëm për mjekët dhe personelin sanitar		Gabim
562	Personi që jep ndihmën në rast aksidenti duhet të vlerësojë situatën me qëllim që të mbrojë të dëmtuarin nga rreziqe të tjera		Saktë
563	Në rast aksidenti, ai që jep ndihmën, duhet të ndihmojë të dëmtuarin sa më mirë të mundet, pa ndërhyrje iniciative që i takojnë organeve kompetente mjekësore		Saktë
564	Në rast aksidenti, ai që jep ndihmën, duhet të sigurojë dhe sinjalizojë sa më mirë zonën e aksidentit		Saktë
565	Në rast aksidenti, ai që jep ndihmën, duhet ti ofrojë të aksidentuarit mbështetje morale		Saktë
566	Në rast aksidenti, ai që jep ndihmën, duhet të largohet nga vendi i aksidentit, pas dhënies së saj		Gabim
567	Në rast aksidenti, ai që jep ndihmën, duhet të distancohet dhe të presë ndihmë pa bërë asgjë		Gabim
568	Në rast aksidenti, ai që jep ndihmën, duhet të identifikojë të dëmtuarin, para se t'ia japë atë		Gabim
569	Në rast aksidenti, ai që jep ndihmën, duhet t'ia japë medikamente të dëmtarit edhe pa pasur kompetencën e duhur, nëse e shikon të arsyeshme		Gabim
570	Qëllimi i ndihmës së parë është të merren masa të thjeshta dhe të shpejta për mbijetesën e të aksidentuarit		Saktë
571	Qëllimi i ndihmës së parë është të ndihmohet i dëmtuari, sa më mirë të jetë e mundur, në pritje të ndihmës mjekësore		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
572	Qëllimi i ndihmës së parë është marrja e masave të thjeshta dhe të shpejta për mbijetesën e të aksidentuarit deri në dhënien e ndihmës mjekësore		Saktë
573	Gjatë dhënies së ndihmës parë duhet të shmanget çdo ndërhyrje e gabuar		Saktë
574	Qëllimi i ndihmës së parë është vendosja e të dëmtuarit në pozicion me të rehatshëm		Gabim
575	Qëllimi i ndihmës së parë është të informohemi nga viktima për rrethanat e aksidentit për t'i referuar autoriteteve kompetente		Gabim
576	Qëllimi i ndihmës së parë është të largojmë në çdo rast të dëmtuarin nga vendi i aksidentit		Gabim
577	Qëllimi i ndihmës së parë është të pengojmë në çdo ndërhyrje për të favorizuar punën e policisë		Gabim
578	Nëse i lënduari, në një aksidenti rrugor, ka një plagë me gjak duhet të mbulohet ajo me material të pastër dhe të shtrëngohet, për të bllokuar rrjedhjen e gjakut		Saktë
579	Nëse i lënduari, në një aksidenti rrugor, ka një plagë me gjak duhet të mos lëvizet trupa të huaj të mundshëm të pranishëm në të		Saktë
580	Nëse i lënduari në një aksidenti rrugor ka një plagë me gjak, duhet të bllokohet rrjedhja e gjakut me garzë sterile ose me copë të pastër		Saktë
581	Nëse i lënduari në një aksidenti rrugor ka një plagë me gjak, duhet të mbahet i dëmtuari në pozicion ulur ose shtrirë		Saktë
582	Nëse i lënduari në një aksidenti rrugor ka një plagë me hemorragji të jashtme, duhet të bllokohet ajo dhe të thirret menjëherë ndihma e shpejtë		Saktë
583	Nëse i lënduari në një aksidenti rrugor ka një plagë me gjak, duhet të nxirren menjëherë trupa të huaj të pranishëm në të, pastaj të mbulohet		Gabim
584	Nëse i lënduari në një aksidenti rrugor ka një plagë me gjak, duhet t'i jepet atij të pijë ujë ose çaj nëse është pa ndjenja		Gabim
585	Nëse i lënduari në një aksidenti rrugor ka një plagë me gjak, duhet të mos mbulohet plaga për të lehtësuar mpiksjen spontane të gjakut		Gabim
586	Nëse i dëmtuari ka një trup të huaj në një sy duhet që me kujdes të lidhet ai pa e nxjerrë trupin e huaj		Saktë
587	Nëse i dëmtuari ka një trup të huaj në një sy duhet të ndalohet që ai të prekë atë, për të shmangur dëmtime më të rënda		Saktë
588	Nëse i dëmtuari ka një trup të huaj në një sy duhet ti lidhet ai dhe të ndalohet të preket deri në ndërhyrjen e një specialisti		Saktë
589	Nëse i dëmtuari ka një trup të huaj në një sy duhet që trupi i huaj të hiqet vetëm nga një mjek specialist		Saktë
590	Nëse i dëmtuari ka një trup të huaj në një sy duhet të bëhet përpjekje për të nxjerrë trupin e huaj për të shmangur infeksionet		Gabim
591	Nëse i dëmtuari ka një trup të huaj në një sy duhet të masazhohet ngadalë ai për të favorizuar lotimin		Gabim
592	Nëse i dëmtuari ka një trup të huaj në një sy duhet të hidhet ujë në të për të mundësuar daljen e tij		Gabim
593	Shenjë që tregon fillimin e gjendjes së shokut është lëkura e ftohtë me ngjyrë shumë të zbehtë		Saktë
594	Shenjë që tregon fillimin e gjendjes së shokut është gjendja e tensionuar dhe djersë të ftohtë në ballë		Saktë
595	Shenjat e fillimit të gjendjes së shokut janë zbehtësi, djersë të ftohta, gjendje e tensionuar, rrahje të zemrës të dobëta por të shpeshta		Saktë
596	Shenjat e fillimit të gjendjes së shokut janë shfaqja e njollave mbi lëkurë		Gabim
597	Shenjat e fillimit të gjendjes së shokut janë shfaqja e ngjyrës së kuqe të lëkurës, që tregon rritje të temperaturës		Gabim
598	Shenjat e fillimit të gjendjes së shokut janë rrahje të forta të zemrës dhe tension i lartë		Gabim



**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
599	Kur i dëmtuari paraqet gjendje shoku duhet të shtrihet në tokë, të mbulohet dhe të mbahen të ngritura gjymtyrët e poshtme		Saktë
600	Kur i dëmtuari paraqet gjendje shoku duhet të mbulohet sa më mirë		Saktë
601	Kur i dëmtuari paraqet gjendje shoku duhet të shtrihet me gjymtyrët e poshtme të ngritura nga trupi		Saktë
602	Kur i dëmtuari paraqet gjendje shoku duhet të ngrihet për të ecur që të riaktivizohet qarkullimi i gjakut		Gabim
603	Kur i dëmtuari paraqet gjendje shoku duhet të vendoset në pozicion ulur		Gabim
604	Kur i dëmtuari paraqet gjendje shoku duhet të goditet me kujdes në fytyrë dhe gjymtyrë për të riaktivizuar qarkullimin e gjakut		Gabim
605	Kur i dëmtuari paraqet gjendje shoku duhet t'i jepen sasi të vogla pije alkoolike		Gabim
606	Nëse i dëmtuari në një aksidenti rrugor është pa ndjenja duhet nëse merr frymë vetë, të vendoset në pozicionin anësor të sigurisë		Saktë
607	Nëse i dëmtuari në një aksidenti rrugor është pa ndjenja duhet nëse nuk merr frymë, t'i lirohet goja edhe hunda nga pengesa të mundshme		Saktë
608	Nëse i dëmtuari në një aksidenti rrugor është pa ndjenja duhet të kujdesesh për gjendjen e tij deri në mbërritjen e ambulancës		Saktë
609	Nëse i dëmtuari në një aksidenti rrugor është pa ndjenja duhet ta bësh të ecë e të flasë me të dëmtuarin për ta mbajtur zgjuar		Gabim
610	Nëse i dëmtuari në një aksidenti rrugor është pa ndjenja duhet ta bësh që të mos mundet fare të lëvizë trupin		Gabim
611	Nëse i dëmtuari në një aksidenti rrugor është pa ndjenja duhet ta fashojsh dhe të bësh që të mos mundet të lëvizë kokën		Gabim
612	Nëse i dëmtuari në një aksidenti rrugor është pa ndjenja duhet të pyetet nëse ka dhembje në kokë		Gabim
613	Në rast se i dëmtuari, i vetëdijshëm, ka një traumë në kafazin e kraharorit duhet nëse e është e nevojshme, t'i lehtësoi frymëmarrjen duke e vendosur të dëmtuarin gjysmë ulur		Saktë
614	Në rast se i dëmtuari, i vetëdijshëm, ka një traumë në kafazin e kraharorit duhet që nëse ka plagë të dukshme dhe të thellë, të shtypet menjëherë me një copë të pastër		Saktë
615	Në rast se i dëmtuari, i vetëdijshëm, ka një traumë në kafazin e kraharorit duhet të ruhet me kujdes deri në mbërritjen e ndihmës të specializuar		Saktë
616	Në rast se i dëmtuari, i vetëdijshëm, ka një traumë në kafazin e kraharorit duhet ta ndihmohet të bëjë frymëmarrje të thella		Gabim
617	Në rast se i dëmtuari, i vetëdijshëm, ka një traumë në kafazin e kraharorit duhet të vendoset i plagosuri në pozicion shtrirë		Gabim
618	Në rast se i dëmtuari, i vetëdijshëm, ka një traumë në kafazin e kraharorit duhet në rast plage të thellë, të pastrohet, dezinfektohet dhe të mjekohet plaga		Gabim
619	Në rast se i dëmtuari, i vetëdijshëm, ka një traumë në kafazin e kraharorit duhet të vendoset i dëmtuari në pozicion drejt për të kufizuar daljen e gjakut		Gabim
620	Nëse i dëmtuari paraqet një ose më shumë fraktura në gjymtyrë, duhet të mos lëvizet derisa pjesët e thyera të së njëjtës gjymtyrë të bëhen të palëvizshme kundrejt njëra tjetrës		Saktë
621	Nëse i dëmtuari paraqet një ose më shumë fraktura në gjymtyrë, plagët e mundshme të shkaktuara nga thyerjet duhet të mbulohen me material të pastër		Saktë
622	Nëse i dëmtuari paraqet një ose më shumë fraktura në gjymtyrë, duhet t'i jepet të plagosurit një pije e fortë alkoolike		Gabim
623	Në rast se në një aksidenti rrugor, ka pasur zjarr dhe i dëmtuari paraqet djegie, duhet të shuhen flakët me batanije ose materiale të tjera të ngjashme		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
624	Në rast se në një aksidenti rrugor, ka pasur zjarr dhe i dëmtuari paraqet djegie, duhet të mos hiqen mbetje të mundshme të veshjeve të ngjitura në pjesët e djegura		Saktë
625	Në rast se në një aksidenti rrugor ka pasur zjarr dhe i dëmtuari paraqet djegie me skuqje të gjymtyrëve, kur është e mundur, duhet të futen ato në ujë të ftohtë për të lehtësuar dhimbjen		Saktë
626	Në rast se në një aksidenti rrugor, ka pasur zjarr dhe i dëmtuari paraqet djegie që përfshijnë trupin, duhet që ato të mbulohen me material të mundshëm steril (të pastër)		Saktë
627	Në rast se në një aksidenti rrugor, ka pasur zjarr dhe i dëmtuari paraqet djegie, duhet nëse ka akoma mbetje të flakëve, të pritët që të shuhen pastaj të ndërhyhet		Gabim
628	Në rast se në një aksidenti rrugor, ka pasur zjarr dhe i dëmtuari paraqet djegie, duhet të hiqen gjithë mbeturinat e veshjeve të djegura në pjesët e dëmtuara		Gabim
629	Në rast se në një aksidenti rrugor, ka pasur zjarr dhe i dëmtuari paraqet djegie, duhet të dezinfektohen djegiet me alkool		Gabim
630	Në rast se në një aksidenti rrugor, ka pasur zjarr dhe i dëmtuari paraqet djegie, duhet vetëm të njoftojmë shërbimin zjarrfikës dhe të presim		Gabim
<b>TEMA VI : NJOHURI PËR MONTIMIN, PËRDORIM DHE KUJDESIN PËR GOMAT. MASAT QË MERREN PËR HEQJEN DHE ZËVENDËSIMIN E RROTAVE</b>			
631	Kur blejmë goma të reja për mjetin duhet të kontrollojmë treguesit e përmasave të gomës		Saktë
632	Kur blejmë goma të reja për mjetin duhet të kontrollojmë edhe treguesin e stinës		Saktë
633	Kur blejmë goma të reja për mjetin duhet të kontrollojmë treguesin e shpejtësisë		Saktë
634	Kur blejmë goma të reja për mjetin duhet të kontrollojmë edhe vitin e prodhimit		Saktë
635	Kur blejmë goma të reja për mjetin duhet të kontrollojmë edhe treguesin për ngarkesën që mban goma		Saktë
636	Kur blejmë goma të reja për mjetin nuk është e nevojshme të verifikohet treguesi për ngarkesën që mban goma		Gabim
637	Kur blejmë goma të reja për mjetin është e nevojshme që të peshohet goma		Gabim
638	Kur blejmë goma të reja për mjetin duhet të kontrollojmë vetëm përmasat e saj		Gabim
639	Kur blejmë goma të reja për mjetin duhet të kontrollojmë vetëm treguesin e shpejtësisë		Gabim
640	Kur blejmë goma të reja për mjetin duhet të kontrollojmë vetëm vitin e prodhimit		Gabim
641	Për të hequr nga mjete rrotën me gomën e dëmtuar dhe për të vendosur rrotën rezervë duhet që mjete të jetë mundësisht në rrugë horizontale		Saktë
642	Për të hequr nga mjete rrotën me gomën e dëmtuar dhe për të vendosur rrotën rezervë duhet që lirim i dadoçekëve të fillojë pasi të bëhet ngritja me krik		Gabim
643	Pas ndërrimit të një rrote me gomën e dëmtuar me rrotën rezervë, duhet që mjete, të ulet nga kriku dhe pastaj të montohen dadiçekët		Gabim
644	Kur gomat e mjetit janë konsumuar tej kufirit të lejuar, për të garantuar sigurinë në qarkullim dhe për të shmangur aksidentet, duhet të zëvendësohen me të reja		Saktë
645	Për të garantuar sigurinë në qarkullim dhe për të shmangur aksidentet është e nevojshme të përdoren goma me dimensione të ndryshme në të njëjtin aks të mjetit		Gabim
646	Përmasat e gomave që duhet të përdorë mjete përcaktohen nga prodhuesi i mjetit dhe gjenden të shënuara në manualin e përdorimit të tij		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
647	Kriku hidraulik, me të cilin pajisen autobusët, shërben për ndërrimin e një rrote, duke e ngritur autobusin edhe kur ai është i ngarkuar. janë të pajisur autobusët, është e mundur të ngrihet autobusi edhe kur është i ngarkuar		Saktë
648	Kriku hidraulik mund të pozicionohet kudo në automjet		Gabim
649	Autobusët dhe kamionët, në rastet kur shpohet një nga gomat, duhet të përdorin gomën rezervë me dimensione më të vogla		Gabim
650	Kriku hidraulik me të cilin janë të pajisur autobusët për ndërrimin e një rrote, ka aftësi ngritëse deri në 900 kilogramë		Gabim
651	Kriku hidraulik me të cilin janë të pajisur autobusët ka aftësi ngritëse deri në 20 tonë		Saktë
652	Për të hequr nga mjete rrotën me gomën e dëmtuar dhe për të vendosur rrotën rezervë duhet që mjete të jetë mundësisht në një rrugë të sheshtë		Saktë
653	Me krikun hidraulik që janë të pajisur autobusët për ndërrimin e një rrote nuk është e mundur të ngrihet autobusi bashkë me pasagjerët		Gabim
654	Ndryshimi i një rrote të një autobusi, nëse automjeti edhe pjesërisht pengon qarkullimin në rrugë, duhet t'u sinjalizohet automjeteve që vijnë me sinjalin e lëvizshëm të rrezikut		Saktë
655	Kriku hidraulik duhet të jetë e vendosur afër rrotës për t'u zëvendësuar dhe duhet të vendoset në kornizë për ngritjen korrekte të automjetit		Saktë
656	Në rast të ndërrimit të një rrote në një autobus, pasagjerët duhet detyrimisht të zbresin nga ai		Gabim
657	Në rast të zëvendësimit të një rrote të autobusit, rrota rezervë duhet të hiqet nga vendi i saj vetëm pasi të keni ngritur automjetin me krik hidraulik		Gabim
658	Nuk duhet të aktivizoni valvulën e uljes së krikut hidraulik, kur jeni akoma nën automjet, në mënyrë që të shmangni aksidentin shtypeni nga ai		Saktë
659	Për të ngritur një autobus me krik hidraulike për ndërrimin e një rrote, të gjithë pasagjerët duhet të zbresin		Gabim
660	Para se të ndërroni një rrotë të një automjeti të rëndë, mjafton të vendosni një kunj të vetme për bllokim, nëse frenat e parkimit janë aktivizuar		Gabim
661	Para se të ndërroni një rrotë të një autobusi, duhet të aktivizoni frenat e parkimit dhe të vendosni bllokuesit në rrotat e tjera për të parandaluar lëvizjen aksidentale të automjetit		Saktë
662	Para se të ndërroni një rrotë të një autobusi në një rrugë të sheshtë, duhet të aktivizoni frenat e parkimit, por nuk është e nevojshme të vendosni pykat bllokuese të rrotave		Gabim
663	Para se të ngrini autobusin për të ndryshuar një rrotë, sigurohuni që të keni gjithçka që ju nevojitet për ta bërë këtë		Saktë
664	Kur ndërroni gomën e një autobusi në korsinë e emergjencës së një autostrade, udhëtarët mund të dalin nga mjete nëse dëshirojnë		Gabim
665	Kur ndërroni një rrotë, është e nevojshme të shtrëngoni bulonat (dadiçekët) "kryq" dhe pak nga një herë, për të siguruar që rrota të afrohet në mënyrë të saktë me mocën e rrotës		Saktë
666	Kur zëvendësoni rrotën e një aksi me rrota të dyfishta është e nevojshme të siguroheni që të dy rrotat të mos fërkohen me njëri-tjetrin gjatë lëvizjes, për të shmangur mbinxehjen e rrezikshme		Saktë
667	Kur zëvendësoni rrotën e një aksi me rrota të dyfishta është e nevojshme të ri poziciononi distancuesin, nëse është i pranishëm		Saktë
668	Kur vendosni rrotën rezervë, mos i shtrëngoni bulonat (dadiçekët) plotësisht, në mënyrë që të mos dëmtoni filetën		Gabim
1025	Navigatori portativ, zakonisht e merr ushqimin me energji elektrike nga priza e ndezësit të cigares dhe mund të lëvizet pa problem nga një mjet në një tjetër		Saktë
1026	Sistemet e navigimit japin informacione rreth shpejtësisë dhe drejtimit të mjetit		Saktë
1027	Navigatori i jep informacion drejtuesit të mjetit mbi rrugën që do të ndjekë nga pika e nisjes deri në pikën e mbërritjes		Saktë
1028	Navigatori ndihmon drejtuesin e mjetit për të zgjedhur rrugën me të mirë nga pozicioni ku ndodhet deri në destinacion e caktuar		Saktë
1029	Navigatori është pajisje e detyrueshme për të gjithë autobusët që transportojnë mbi 22 udhëtarë		Gabim
1030	Mjetet e pajisura me tahograf kanë detyrim ligjor të pajisen edhe me navigator		Gabim
1031	Kur drejtoni një autobusi duhet të merret parasysh që dukshmëria indirekte përmes pasqyrave ose kamerave, sidoqoftë, lë "zona hije" (këndet e vdekura të pamjes) ku nuk është e mundur të shihen automjete ose këmbësorë		Saktë
1032	Në ndalesa, për të garantuar sigurinë e udhëtarëve të autobusëve, para se të nisen, pozicioni i tyre duhet të kontrollohet me kujdes përmes pasqyrave të brendshme të autobusit		Saktë
1033	Në ndalesa, në mënyrë që të sigurohet një zbritje ose hipje e sigurt e pasagjerëve, pozicioni i pasagjerëve dhe përdoruesve në afërsi duhet të kontrollohet me kujdes, si përmes pasqyrave të jashtme dhe atyre të brendshme të autobusit, përpara se të hapni ose mbyllni dyert		Saktë
1034	Pasqyrat e brendshme të autobusëve përdoren për të kontrolluar situatën në bordin e automjetit pranë dyerve të hipjes dhe hipjes së pasagjerëve		Saktë
1035	Pasqyrat e komanduara në mënyrë elektrike të autobusëve orientohen automatikisht kur karta e tahografit të drejtuesit futet në tahografin digjital		Gabim
1036	Pasqyrat e pasme nuk kanë nevojë të orientohen para se të nisen, por vetëm pasi të keni përshkruar disa kilometra dhe automjeti është futur në qarkullim		Gabim
1037	Fushëpamja në një automjet mund të kufizohet nga lartësia e automjetit		Saktë
1038	Fushëpamja në një automjet mund të kufizohet nga vendosja e pasqyra të tepërta të pamjes së pasme		Gabim
1039	Fushëpamja në një automjet mund të kufizohet nga lloji i ndërtimit të strukturës së kabinës		Saktë
1040	Fushëpamja në një automjet mund të kufizohet nga fshirësit e xhamave		Gabim
1041	Fushëpamja në një automjet mund të kufizohet kur xhami i përparmë është i temperuar		Gabim
1042	Tek automjet e projektuar pa dritare prapa fushëpamja mund të kufizohet		Saktë
1043	Tek automjet e projektuar me dritare prapa fushëpamja mund të kufizohet		Gabim
1044	Fushëpamja në një automjet mund të kufizohet nga prania e frikëseve të zjarrit		Gabim
1045	Në një automjet të rëndë, pasqyrat e pasme mund të zëvendësohen plotësisht nga kamerat		Gabim
1046	Në një automjet të rëndë, pasqyrat anësore të përparme ju lejojnë të shihni më mirë pjesën e poshtme të pjesës së përparme të automjetit		Saktë
1047	Në një autobus, pasqyra kryesore e jashtme djathtas lejon shikimin indirekt edhe të një pjese të rrugës prapa, në të majtë të tij		Gabim
1048	Në një autobus, pasqyra kryesore e jashtme djathtas lejon shikimin indirekt edhe të një pjese të rrugës prapa, në të djathtë të tij		Saktë
1049	Në një autobus, pasqyra kryesore e jashtme majtas lejon shikimin indirekt edhe të një pjese të rrugës prapa, në të djathtë të tij		Saktë
1050	Në një autobus, pasqyra kryesore e jashtme majtas lejon shikimin indirekt edhe të një pjese të rrugës prapa, në të majtë të tij		Gabim
1051	Në një autobus, pasqyra rrethore e brendshme me kënd të gjerë të pamjes së pasme lejon drejtuesin të shikojë tavanin e tij		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1052	Në një autobus, pasqyra rrethore e brendshme ju lejon të zgjeroni këndin e shikimit të kontrolluar nga pasqyra kryesore e pamjes së pasme		Saktë
1053	Rregullimi i saktë i pasqyrave të pasme të automjeteve të rënda është një element themelor për zvogëlimin e aksidenteve që përfshijnë ato		Saktë
1054	Pamja indirekte përmes pasqyrave ose kamerave ju lejon të kontrolloni plotësisht të gjithë këndet e pamjes së rrugës		Gabim
1055	Për të siguruar një fushëpamje më të mirë të drejtpërdrejtë të rrugës, dritat e brendshme të automjetit duhet të ndizen në të gjitha kushtet e dukshmërisë së dobët		Gabim
1056	Për të siguruar një fushëpamje më të mirë të drejtpërdrejtë të rrugës është e nevojshme të errësohen plotësisht dritaret anësore të djathtë kur dielli perëndon në atë anë		Gabim
1057	Për të siguruar një fushëpamje më të mirë të drejtpërdrejtë të rrugës është e nevojshme të shmangni përdorimin e mbrojtëseve nga dielli		Gabim
1058	Për të siguruar një fushëpamje më të mirë të drejtpërdrejtë të rrugës, gominat e fshirëseve të xhamave duhet të zëvendësohen sa herë që ndërrohet filtri naftës		Gabim
1059	Për të siguruar një fushëpamje më të mirë të drejtpërdrejtë të rrugës vendi i uljes së drejtuesit duhet të rregullohet saktë në lartësi		Saktë
1060	Për të siguruar një fushëpamje më të mirë të drejtpërdrejtë të rrugës, është e nevojshme të shmangni lënien e hartave, ditarëve dhe shënimeve në panel, veçanërisht nëse ato janë me ngjyra të lehta, pasi ato mund të krijojnë reflektime të rrezikshme në xhamin e përparmë		Saktë
1061	Për të siguruar fushëpamje më të mirë të drejtpërdrejtë të rrugës, është e nevojshme të shmanget mbajtja nderur e dritave të brendshme të automjetit gjatë orëve të natës, pasi ato kufizojnë përshtatjen e syrit me shikimin në errësi		Saktë
1062	Për të siguruar fushëpamje më të mirë të drejtpërdrejtë të rrugës, është e nevojshme të shmangni mjegullimin e xhamave të përparme dhe anësorë		Saktë
1063	Për të siguruar një dukshmëri më të mirë të drejtpërdrejtë të rrugës, gominat e fshirëseve të xhamave duhet të zëvendësohen kur nuk janë më në gjendje të mirë pune		Saktë
1064	Për një rregullim korrekt të pasqyrave anësore të pasme të autobusëve është e nevojshme të kihet parasysh mundësia që drejtuesi të mbajë syze		Gabim
1065	Për një rregullim korrekt të pasqyrave anësore të pasme të autobusëve është e nevojshme të merren parasysh kushtet atmosferike, veçanërisht era		Gabim
1066	Për një rregullim korrekt të pasqyrave anësore të pasme të autobusëve, duhet të konsiderohet që fushëpamja e anës së djathtë të rrugës është veçanërisht e rëndësishme		Saktë
1067	Nëse pasqyrat e brendshme të një autobusi orientohen gabim, nuk ka shumë rëndësi nëse pasqyrat e jashtme janë në pozicionin e duhur		Gabim
1068	Nëse pasqyrat e brendshme të një autobusi janë të orientuara gabim, mund të ndodhë që drejtuesi të mbyllë dyert dhe të nisët kur njerëzit nuk kanë mbaruar hipjen ose zbritjen		Saktë
1069	Nëse pasqyrat e brendshme të një autobusi janë të orientuara gabim, mund të ndodhë që drejtuesi të mos shohë nëse ka njerëz në stacionin e autobusit që presin që autobusin		Gabim
1070	Gjatë drejtimit të një autobusi në autostradë, pasqyra e jashtme e pamjes së pasme duhet të mbyllet		Gabim
1071	Shikueshmëria indirekte përmes pasqyrave ose kamerave është efektive vetëm nëse ato janë të orientuara saktë		Saktë
1072	Pasqyrat e pasme të autobusëve orientohen automatikisht kur karta e tahogرافit futet në tahogرافin digjital		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

Nr.	Përmbajtja	Figura	Përgjigja
<b>TEMA IX : LIDHJA E RIMORKIOVE DHE GJYSMËRIMORKIOVE. NJOHURI MBI LLOJET, NDËRTIMI, PJESËT KRYESORE, LIDHJA ,PËRDORIMI DHE MIRËMBAJTJA E PËRDITSHME E SISTEMEVE LIDHËSE</b>			
1073	Rimorkiot janë mjete të destinuar për t'u tërhequr nga automjetet dhe nga trolejbusët, përjashtuar artikularët		Saktë
1074	Karrelat bëjnë pjesë në grupin e rimorkiove		Saktë
1075	Rimorkiot për transport të pajisjeve turistike dhe sportive (me një ose me dy akse) bëjnë pjesë në grupin e rimorkiove,		Saktë
1076	Automjetet në avari që tërhiqen nga një automjet tjetër, konsiderohen rimorkio		Gabim
1077	Rimorkiot, përveç atyre me një aks dhe peshë deri 0.75 ton, duhet të kenë sistem frenimi		Saktë
1078	Rimorkiot duhet të kenë treguesin e ndritshëm të drejtimit (sinjale)		Saktë
1079	Rimorkiot nuk lejohet të qarkullojnë nëse nuk janë të kompletuara me sistemet e pajimit të parashikuara nga Kodi Rrugor		Saktë
1080	Rimorkiot janë të pajisur me mekanizmin e mbrojtjes (bllokazh motori)		Gabim
1081	Rimorkiot kanë treguesin kilometrik të dyllosur		Gabim
1082	Rimorkiot duhet të pajisen vetëm me mekanizmin që e lidh atë me mjetin që e tërheq		Gabim
1083	Në lejen e qarkullimit është shënuar masa maksimale teknikisht e lejuar e rimorkios që mund të tërhiqet në frenim (kg)		Saktë
1084	Në lejen e qarkullimit është shënuar masa maksimale teknikisht e lejuar e rimorkios që mund të tërhiqet në lëvizje (kg)		Saktë
1085	Në lejen e qarkullimit të rimorkios shënohet ngjyra e karrocisë		Saktë
1086	Të dhënat mbi identifikimin dhe karakteristikat teknike të rimorkios me dy a më shumë akse, janë të shënuara në leje qarkullimi		Saktë
1087	Të dhënat mbi identifikimin dhe karakteristikat teknike të rimorkios me dy a më shumë akse, janë të shënuara edhe në lejen e qarkullimit të automjetit tërheqës		Gabim
1088	Të dhënat mbi identifikimin dhe karakteristikat teknike të rimorkios me dy a më shumë akse, janë të shënuara edhe në certifikatën e pronësisë të kamionit tërheqës		Gabim
1089	Për tërheqjen e rimorkios ose të gjysmërimorkios është e nevojshme që të jenë kontrolluar kushtet e brendashkrimit në kthesë		Saktë
1090	Për tërheqjen e rimorkios ose të gjysmërimorkios është e nevojshme që sistemet e frenimit dhe ndriçim-sinjalizimit të të dy mjeteve, që bëjnë pjesë në kompleks, të jenë të pajtueshme (me puthitshmëri) ndërmjet tyre		Saktë
1091	Për tërheqjen e rimorkios është e nevojshme që pajisjet e tërheqjes të jenë të tipit të miratuara dhe të pajtueshëm ndërmjet tyre		Saktë
1092	Për tërheqjen e rimorkios mjafton që pajisjet e tërheqjes të jenë të tipit të miratuar dhe të pajtueshëm (me puthitshmëri) midis tyre		Gabim
1093	Për tërheqjen e rimorkios është e nevojshme që vetëm të jenë kontrolluar kushtet e brendashkrimit të kthesës		Gabim
1094	Për tërheqjen e rimorkios ose të gjysmërimorkios mjafton që sistemet e lidhjes se frenave të të dy mjeteve të kompleksit të jenë të pajtueshëm midis tyre		Gabim
1095	Kur rimorkio nuk është pajisur me sistem frenash, raporti ndërmjet masës së përgjithshme me ngarkesë të plotë të rimorkios me masën maksimale të autobusit, nuk duhet të kalojë 0.50		Saktë
1096	Kur rimorkio nuk është pajisur me sistem frenash, raporti ndërmjet masës së përgjithshme me ngarkesë të plotë të rimorkios me masën e përgjithshme me ngarkesë të plotë të mjetit tërheqës, mund të jetë deri në 0.8		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1097	Kur kompleksi i mjeteve është i pajisur me sistem frenash të tipit të vazhduar dhe automatik, raporti ndërmjet masës së përgjithshme me ngarkesë të plotë të rimorkios me masën e përgjithshme me ngarkesë të plotë të mjetit tërheqës, nuk duhet të kalojë 0.5		Saktë
1098	Prova praktike për përcaktimin e masës së rimorkiuar që kryhet për ngarkesë të plotë duhet të pranojë që kompleksi i mjeteve të mund të niset mbi një pjerrësi (në ngjitje) 8%		Gabim
1099	Prova praktike për përcaktimin e masës së rimorkiuar që kryhet për ngarkesë të plotë, duhet të pranojë që kompleksi i mjeteve të mund të niset në një pjerrësi (në ngjitje) mbi 10%		Saktë
1100	Rimorkiot janë mjete të destinuara për tu tërhequr nga automjetet dhe trolejbusët, përjashtuar artikularët		Saktë
1101	Rimorkiot janë mjete që mund të shërbejnë edhe për transport pasagjerësh		Saktë
1102	Rimorkiot janë mjete që mund të tërhiqen edhe nga autoveturat		Gabim
1103	Rimorkiot janë mjete të destinuara për tu tërhequr nga autotrenat, artikularët dhe gjysmërimorkiatorët		Gabim
1104	Rimorkiot janë mjete që futen në kategorinë e mjeteve me motor		Gabim
1105	Rimorkiot janë mjete që futen në kategorinë e automjeteve		Saktë
1106	Rimorkiot kanë pjesë përbërëse shasinë		Saktë
1107	Rimorkiot kanë në përbërje edhe mekanizmin e lidhjes me mjetin që e tërheq		Saktë
1108	Rimorkiot duhet të jenë të pajisur me sistemin e ndriçimit dhe sinjalizimeve		Saktë
1109	Rimorkiot me dy a më shumë akse, duhet detyrimisht të kenë sistem frenimi		Gabim
1110	Rimorkiot nuk kanë suspencione (balestra) dhe amortizatorë		Gabim
1111	Rimorkiot janë të pajisura me sistem drejtimi hidraulik		Gabim
1112	Rimorkiot futen në kategorinë e mjeteve me motor		Saktë
1113	Gjysmërimorkiot në pjesën e përparme mbështeten tek tërheqësit		Saktë
1114	Gjysmërimorkiot mund të jenë vetëm me një aks		Saktë
1115	Gjysmërimorkiot tërhiqen vetëm nga tërheqësit		Saktë
1116	Gjysmërimorkiot duhet të kenë edhe sistemin e ndriçimit dhe të sinjalizimeve		Gabim
1117	Gjysmërimorkiot hyjnë te mjetet me motor		Gabim
1118	Gjysmërimorkiot duhet te kenë edhe sistem drejtimi		Gabim
1119	Gjysmërimorkiot mund të tërhiqen nga çdo lloj automjeti		Saktë
1120	Karrelat janë të destinuara për transport bagazhesh, pajisjesh, etj., si këto		Saktë
1121	Karrelat konsiderohen si pjesë përbërëse e automjeteve		Saktë
1122	Karrelat mund të tërhiqen nga kamionët		Gabim
1123	Karrelat mund të jenë edhe me dy akse		Gabim
1124	Karrelat lejohet të tërhiqen nga autotrenat, gjysmërimorkiatorët dhe makinat e ngarkim-transportit		Gabim
1125	Karrelat tërhiqen vetëm nga autoveturat		Saktë
1126	Në rimorkio dhe gjysmërimorkio duhet të kontrollohen akset mbajtëse të rrotave (asaljet) për ndonjë deformim apo plasaritje		Saktë
1127	Në rimorkio dhe gjysmërimorkio duhet të kontrollohen mekanizmi i kthimit, elementët e sistemit të varjes (balestrat), etj.		Saktë
1128	Në rimorkio dhe gjysmërimorkio duhet të kontrollohen funksionimi i pajisjeve lidhëse të tubove		Saktë
1129	Në rimorkio dhe gjysmërimorkio duhet të kontrollohen sistemet e frenimit, ndriçim-sinjalizimit, gomat, etj.		Gabim
1130	Në rimorkio dhe gjysmërimorkio duhet të kontrollohen vetëm sistemet e frenimit dhe ndriçim-sinjalizimit		Gabim
1131	Në rimorkio dhe gjysmërimorkio duhet të kontrollohen përmasat e spinotit, ganxhës lidhëse të timonit dhe madhësia e qarkut		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1132	Në rimorkio dhe gjysmërimorkio duhet të kontrollohet vetëm mirëfunksionimi i mekanizmit të kthimit		Saktë
1133	Mekanizmi i kthimit të rimorkios përbëhet nga timoni (traversa) që lidhet me qarkun e rimorkios i cili ndodhet në aksin e parë		Saktë
1134	Mekanizmi i kthimit të rimorkios mund të ketë edhe pajisje për bllokimin e tij që përdoret në rastet e lëvizjes prapa		Saktë
1135	Mekanizmi i kthimit të rimorkios përbëhet vetëm nga timoni (traversa)		Gabim
1136	Mekanizmi i kthimit të rimorkios përbëhet vetëm nga qarku që mbështetet në shasinë e rimorkios		Gabim
1137	Lidhja e rimorkios me kamionin duhet të jetë e siguar me lidhje shtesë sigurie		Saktë
1138	Mekanizmi i lidhjes së rimorkios me kamionin ka në përbërje takon e rimorkimit që është e montuar te shasia e kamionit		Saktë
1139	Lidhja e rimorkios me kamionin realizohet nëpërmjet spinotit që lidh ganxhën e timonit të rimorkios me takon e kamionit		Saktë
1140	Mekanizmi i lidhjes së rimorkios me kamionin duhet të realizojë lidhje të sigurte të kamionit me rimorkion		Saktë
1141	Mekanizmi i lidhjes së rimorkios me kamionin lejohet edhe pa lidhje të dyfishtë sigurie kur rimorkio është me peshë të përgjithshme më të vogël se 3.5 ton		Gabim
1142	Mekanizmi i lidhjes së rimorkios me kamionin kërkon detyrimisht lidhjen e sigurisë me kavo ose zinxhirë çeliku vetëm kur rimorkio është me peshë të përgjithshme mbi 3.5 ton		Gabim
1143	Mekanizmi i lidhjes së rimorkios me kamionin nuk përmban lidhje sigurie		Gabim
1144	Kur drejtuesi i automjetit bën lidhjen e rimorkios me kamionin duhet të vendosë në mënyrë të sigurte timonin e saj, në takon e mjetit tërheqës		Saktë
1145	Kur drejtuesi i automjetit bën lidhjen e rimorkios me kamionin duhet të bëjë lidhjen e linjave të ajrit të sistemit të frenimit të mjetit tërheqës me atë të rimorkios		Saktë
1146	Kur drejtuesi i automjetit bën lidhjen e rimorkios me kamionin duhet të bëjë lidhjen e impiantit elektrik për sistemin e ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1147	Kur drejtuesi i automjetit bën lidhjen e rimorkios me kamionin mjafton të bëjë lidhjen e impiantit elektrik për sistemin e ndriçim sinjalizimit		Gabim
1148	Kur drejtuesi i automjetit bën lidhjen e rimorkios me kamionin mjafton të bëjë lidhjen e linjave të ajrit të sistemit të frenimit të mjetit tërheqës me atë të rimorkios		Gabim
1149	Kur drejtuesi i automjetit bën lidhjen e rimorkios me kamionin mjafton të lidhë timonin në takon e mjetit tërheqës		Gabim
1150	Për të bërë lidhjen e gjysmërimorkios me tërheqësin duhet të behet futja e sigurte e spinotit në platformën mbështetëse dhe të sigurohet lidhja me bravën e sigurisë		Saktë
1151	Për të bërë lidhjen e gjysmërimorkios me tërheqësin duhet të bëhet lidhja e linjave të ajrit të sistemit të frenimit të tërheqësit me ato të saj		Saktë
1152	Për të bërë lidhjen e gjysmërimorkios me tërheqësin duhet të bëhet lidhja e impiantit elektrik, për sistemin e ndriçimit dhe sinjalizimeve të saj		Saktë
1153	Për të bërë lidhjen e gjysmërimorkios me tërheqësin duhet në fillim të çaktivizojmë mekanizmin e qëndrimit		Gabim
1154	Kur drejtuesi i automjetit bën lidhjen e gjysmërimorkios me tërheqësin duhet vetëm të heqë këmbët mbajtëse të gjysmërimorkios		Gabim
1155	Për të bërë shkëputjen e tërheqësit nga gjysmërimorkioja, fillimisht duhet zgjedhur një vend me sipërfaqe të sheshtë për të parkuar gjysmërimorkion		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1156	Për të bërë shkëputjen e tërheqësit nga gjysmërimorkioja, pas aktivizimit të mekanizmit të qëndrimit, duhet bërë shkëputja e linjave të ajrit dhe atyre elektrike		Saktë
1157	Për të bërë shkëputjen e tërheqësit nga gjysmërimorkioja duhet të lëshohen këmbët mbajtëse të saj në tokë, para largimit të tërheqësit		Saktë
1158	Për të bërë shkëputjen e tërheqësit nga gjysmërimorkioja duhet bërë edhe vendosja e pykave të sigurimit në rrota para largimit të tërheqësit		Saktë
1159	Për të bërë shkëputjen e tërheqësit nga gjysmërimorkioja duhet bërë shkëputja e linjës së ajrit të frenave, para aktivizimit të mekanizmin të qëndrimit		Gabim
1160	Për të bërë shkëputjen e tërheqësit nga gjysmërimorkioja duhet bërë aktivizimi i mekanizmit të qëndrimit pasi të keni lëshuar në tokë këmbët mbajtëse të gjysmërimorkios		Gabim
1161	Për të bërë shkëputjen e tërheqësit nga gjysmërimorkioja fillimisht duhet të zgjidhet një vend me sipërfaqe të pjerrët për të parkuar gjysmërimorkion		Gabim
1162	Rimorkiot me një aks me peshë nën 0.75 ton mund të mos pajisen me sistem frenimi		Saktë
1163	Rimorkiot me peshë të përgjithshme mbi 0.75 ton duhet të pajisen me sistem frenimi		Saktë
1164	Rimorkiot me dy akse duhet patjetër të pajisen me sistem frenimi në një aks		Saktë
1165	Rimorkiot me masë deri 3.5 ton mund të jenë me sistem frenimi mekanik të tipit me inerci		Saktë
1166	Rimorkiot me masë deri 7 ton duhet të pajisen me sistem frenimi mekanik		Gabim
1167	Me sistem frenimi, të tipit të vazhduar automatik, duhet të pajisen të gjitha rimorkiot pavarësisht nga pesha e tyre		Gabim
1168	Rimorkiot me peshë të përgjithshme mbi 0.75 ton nuk e kanë të detyrueshme të pajisen me sistem frenimi		Gabim
1169	Frenat e tipit me inerci kërkojnë një sistem oleo-pneumatik në rimorkio		Gabim
1170	Sistemi i frenimit të një rimorkio që peshon deri në 3.5 ton nuk është kurrë mekanik		Gabim
1171	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë ) funksionon në rast të këputjes së tubit të ajrit që vjen nga mjeti tërheqës		Saktë
1172	Sistemi i frenimit të një rimorkio me një masë deri në 3.5 ton mund të jetë me inerci dhe hidraulik		Saktë
1173	Sistemi i frenimit të një rimorkio me një masë deri në 3.5 ton mund të jetë me inerci dhe mekanik		Saktë
1174	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë ) vepron nëse rimorkio shkëputet nga kamioni aksidentalisht		Saktë
1175	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë ) shërben kur drejtuesi i mjetit e shkëput rimorkion nga tërheqësi		Saktë
1176	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë ) realizon ndalimin e rimorkios, pa veprimin e drejtuesit të mjetit		Saktë
1177	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë ) funksionon në përputhje me shtypjen e pedalit të frenit në tërheqës		Gabim
1178	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë ) komandohet nga drejtuesi i mjetit gjatë lëvizjes		Gabim
1179	Frenimi automatik i rimorkios (frenimi i sigurisë ) nuk vepron kur drejtuesi i mjetit e shkëput rimorkion nga tërheqësi		Gabim
1180	Frenat e shërbimit të rimorkios funksionojnë në përputhje me shtypjen e pedalit të frenit në tërheqës		Saktë
1181	Frenat e shërbimit të rimorkios realizojnë fillimin e frenimit të rimorkios njëkohësisht ose më përpara se të tërheqësit		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1182	Frenat e shërbimit të rimorkios realizojnë një forcë frenimi në rrotë që përputhet me korsën e pedalit të frenave të tërheqësit		Saktë
1183	Frenat e shërbimit të rimorkios realizon ndalimin e rimorkios pa veprimin e drejtuesit të mjetit		Gabim
1184	Frenat e shërbimit të rimorkios nuk shërbejnë gjatë lëvizjes normale të mjetit		Gabim
1185	Frenat e shërbimit të rimorkios veprojnë nëse rimorkio shkëputet nga kamioni aksidentalisht		Gabim
1186	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios mund të jenë mekanike ose me ajër (pneumatike)		Saktë
1187	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios kur janë me ajër (pneumatike) aktivizohen me anë të valvolës të frenave të qëndrimit që ndodhen në kabinën e tërheqësit		Saktë
1188	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios komandohen nga drejtuesi i mjetit te valvola e frenave të qëndrimit (parkimit)		Saktë
1189	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios përdoren edhe gjatë lëvizjes në raste emergjente		Gabim
1190	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios komandohen nga drejtuesi i mjetit te valvola e frenave të shërbimit		Gabim
1191	Frenat e qëndrimit (parkimit) të rimorkios dhe gjysmërimorkios veprojnë nëse rimorkio shkëputet nga kamioni aksidentalisht		Gabim
1192	Dritat e pozicionit të vendosur prapa janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1193	Sinjalet e drejtimit të vendosur prapa janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1194	Sinjalet reflektues me ngjyrë të kuqe që vendosen prapa janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1195	Sinjalet reflektues me ngjyrë të bardhë që vendosen para janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1196	Panelet reflektuese të vendosur prapa rimorkios, janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit kur pesha e përgjithshme e rimorkios është mbi 3.5 ton		Saktë
1197	Dritat e sinjaleve të frenave janë pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios		Saktë
1198	Pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios janë vetëm dy sinjalet reflektuese		Gabim
1199	Pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios janë edhe dy fenerë kundër mjegullës të vendosur në pjesën e përparme		Gabim
1200	Pjesë e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimeve të rimorkios janë dy panelet reflektuese të vendosur në pjesën e përparme		Gabim
<b>TEMA X : NDËRTIMI DHE FUNKSIONIMI I MOTORËVE ME DJEGIE TË BRENDSHME, LËNGJET (P.SH., VAJI I MOTORIT, LËNGU FTOHËS), SISTEMI I USHQIMIT, SISTEMI ELEKTRIK, SISTEMI I NDEZJES, SISTEMET E TRANSMETIMIT TË LËVIZJES (FRIKSIONI, KUTIA E SHPEJTËSISË ETJ.)</b>			
1201	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes mundësojnë transmetimin e lëvizjes nga motori tek rrotat aktive të automjetit		Saktë
1202	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes përbëhen nga friksioni, kutia e shpejtësisë, transmisioni, diferenciali, etj.		Saktë
1203	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes realizojnë edhe zvogëlimin e ngarkesave përdredhëse dinamike që transmetohen në motor		Saktë
1204	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes shërbejnë vetëm për transmetimin e lëvizjes nga kutia e shpejtësisë, te rrotat aktive		Gabim
1205	Sistemi satelitor GPS është pjesë e sistemit të transmetimit të lëvizjes		Gabim



**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1206	Në shumë autobusë, transmetimi hidraulik zëvendëson friksionin dhe kutinë e ndërrimit të shpejtësisë manuale		Saktë
1207	Elementët e sistemit të transmetimit të lëvizjes përdoren për ta mbajtur kompaninë të informuar për pozicionin e automjetit		Gabim
1208	Elementët e sistemit të transmetimit të lëvizjes nuk gjenden në automjetet elektrike		Gabim
1209	Semiakset (gjysmëakset) nuk bëjnë pjesë në sistemin e transmetimit të lëvizjes së automjetit		Gabim
1210	Mekanizmat e transmetimit të lëvizjes janë pjesë të motorit		Gabim
1211	Balestra, volani dhe kufizuesi i shpejtësisë janë pjesë e sistemit të transmetimit të lëvizjes		Gabim
1212	Friksioni, kutia e shpejtësisë dhe diferenciali janë pjesë e sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1213	Friksioni është pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1214	Kutia e shpejtësisë (kambio) është pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1215	Transmisioni kardanik është pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1216	Diferenciali dhe gjysmëakset (semiakset) janë pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1217	Boshti motorik është pjesë e mekanizmave të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Gabim
1218	Stabilizatorët me balestrat e mjeti janë pjesë e mekanizmave përbërës të sistemit të transmetimit të lëvizjes		Gabim
1219	Friksioni realizon transmetimin dhe shkëputjen e lëvizjes nga boshti motorik në boshtin primar të kutisë së shpejtësisë		Saktë
1220	Friksioni mund të jetë mekanik ose hidraulik		Saktë
1221	Disa automjete janë të pajisura me një friksion me shumë disqe		Saktë
1222	Friksioni bën të mundur nisjen e qetë të mjetit nga vendi		Saktë
1223	Friksioni mbron motorin dhe mekanizmat e tjerë të lëvizjes nga mbingarkesat dinamike		Saktë
1224	Friksioni është mirë të shtypet shpesh për të zvogëluar distancën e sigurisë me mjetin para		Gabim
1225	Friksioni është pjesë e motorit		Gabim
1226	Friksioni transmeton lëvizjen nga kutia e shpejtësisë në diferencial		Gabim
1227	Friksioni mekanik ndihmon drejtuesin e mjetit për të realizuar ndërrimin e marsheve		Saktë
1228	Friksioni mekanik mund të ketë sistem komandimi të tipit mekanik, hidraulik apo me ajër (pneumatik)		Saktë
1229	Friksioni mekanik shërben edhe për zbutjen e ngarkesave dinamike që lindin gjatë lëvizjes së mjetit		Saktë
1230	Friksioni mekanik realizon transmetimin e lëvizjes nëpërmjet vajit		Gabim
1231	Friksioni mekanik përbëhet vetëm nga disku i friksionit me ferrota		Gabim
1232	Friksioni mekanik merr lëvizjen nga kutia e shpejtësisë (kambio)		Gabim
1233	Friksioni mekanik realizon ndezjen e motorit		Gabim
1234	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik ndërpret transmetimin e lëvizjes nga boshti i motorit për në rrotat aktive të mjetit		Saktë
1235	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik shkakton ndarjen e diskut (apo disqeve) me ferrota nga volani i motorit		Saktë
1236	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik realizohet nga drejtuesi i mjetit me këmbën e majtë		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1237	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik e mbajtur për një kohë të gjatë dëmton kushinetën e friksionit		Saktë
1238	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik siguron ndërrimin e lehtë të marsheve		Saktë
1239	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik realizon transmetimin e fuqisë motorike në rrotat drejtuese të mjetit		Gabim
1240	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik gjatë lëvizjes së mjetit sjell ndaljen e menjëhershme të tij		Gabim
1241	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik shkakton bashkimin e disqeve të friksionit		Gabim
1242	Shtypja e pedalit të friksionit mekanik shërben për transmetimin e lëvizjes		Gabim
1243	Friksioni mekanik mund të jetë me një ose disa disqe		Saktë
1244	Friksioni mekanik ka në përbërje të tij diskun (apo disqet) me ferrota dhe diskun shtrëngues (spinxhidiskun)		Saktë
1245	Friksioni mekanik përdoret dhe në mjetet e rënda		Saktë
1246	Friksioni mekanik është pjesë e motorit		Gabim
1247	Friksioni mekanik përbëhet nga disku i friksionit, i cili e merr lëvizjen nga kutia e shpejtësisë		Gabim
1248	Friksioni mekanik punon në ambient vaji		Gabim
1249	Friksioni hidraulik është pjesë e mekanizmave të transmetimit të lëvizjes		Saktë
1250	Friksioni hidraulik transmeton xhirot e boshtit motorik në boshtin e parë të kutisë së shpejtësisë (kambios)		Saktë
1251	Friksioni hidraulik përbëhet nga pjesa aktive (pompa) dhe ajo pasive (turbina)		Saktë
1252	Friksioni hidraulik punon me vaj hidraulik i cili duhet të ndërrohet periodikisht		Saktë
1253	Friksioni hidraulik është pjesë e motorit		Gabim
1254	Friksioni hidraulik punon me vajin e motorit		Gabim
1255	Friksioni hidraulik nuk është pjesë e mekanizmave të transmetimit të fuqisë		Gabim
1256	Friksioni me shumë disqe është i përshtatshëm veçanërisht për automjetet me masë dhe / ose fuqi të madhe		Saktë
1257	Friksioni me shumë disqe nuk vendoset asnjëherë në automjete të rënda		Gabim
1258	Friksioni me shumë disqe mund të jetë i thatë ose i lagur me ujë		Gabim
1259	Friksioni me shumë disqe mund të jetë i thatë ose i lagur me vaj		Saktë
1260	Friksioni me shumë disqe mund të vendoset vetëm në automjete me kuti ndërrimi të shpejtësisë automatike		Gabim
1261	Friksioni me shumë disqe mund të jetë vetëm i thatë		Gabim
1262	Friksioni me shumë disqe përdoret nëse kutia e shpejtësisë ka më shumë se 4 raporte shpejtësie (marshe)		Gabim
1263	Friksioni lejon të ndryshoni marshet kur automjeti është në lëvizje		Saktë
1264	Friksioni lejon të lidhni dhe shkëputni motorin me përbërësit e tjerë të sistemit të transmetimit		Saktë
1265	Friksioni lejon të lidhni dhe shkëputni gradualisht motorin me rrotat e aktive		Saktë
1266	Friksioni lejon të lidhni dhe shkëputni gradualisht motorin me pompën e injektimit		Gabim
1267	Friksioni lejon të lëvizni automjetin duke bashkuar gradualisht boshtin motorik me rrotat aktive përmes elementëve të sistemit të transmetimit		Saktë
1268	Friksioni mban motorin në punë kur automjeti është i palëvizshëm me një marsh të ingranuar		Saktë
1269	Friksioni është komponenti kryesor i sistemit të transmetimit automatik		Gabim
1270	Friksioni është vendosur midis kutisë së shpejtësisë dhe boshtit kardanak		Gabim
1271	Friksioni ftohet nga një ventilator special		Gabim
1272	Friksioni është një pajisje që lejon boshtin motorik të rrotullohet pa transmetuar lëvizje në elementët e sistemit të transmetimit		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1273	Friksioni është një pajisje që ju lejon të ndryshoni raportin midis numrit të rrotullimeve të boshtit motorik dhe numrit të rrotullimeve të boshtit kardanik të transmetimit		Gabim
1274	Friksioni është një mekanizëm që funksionon me anë të fërkimit		Saktë
1275	Friksioni është pjesë e përbërësve e sistemit të shuarjes së lëkundjeve (amortizimit)		Gabim
1276	Friksioni nuk ka nevojë për mirëmbajtje pasi është vetë-rregullues		Gabim
1277	Disku i friksionit është i lidhur direkt me boshtin ndihmës të kutisë së shpejtësisë		Gabim
1278	Disku i friksionit është i lidhur direkt me boshtin hyrës (primar) të kutisë së shpejtësisë		Saktë
1279	Disku i friksionit është i lidhur direkt me boshtin e transmetimit (sekondar) të kutisë së shpejtësisë		Gabim
1280	Disku i friksionit është prej çeliku dhe nuk ka asnjë shtresë		Gabim
1281	Disku i friksionit nuk duhet të ketë kurrë kontakt me volanin		Gabim
1282	Disku i friksionit, kur friksioni është i stakuar (pedali i ngritur), është në kontakt me volanin		Saktë
1283	Ferota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit duhet të lubrifikohet dhe grasatohet periodikisht		Gabim
1284	Ferota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit duhet të pastrohet periodikisht me benzinë		Gabim
1285	Ferota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit i nënshtrohet konsumimit		Saktë
1286	Ferota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit nuk i nënshtrohet konsumimit		Gabim
1287	Ferota (material kundër fërkimi) e vendosur tek disku i friksionit kur konsumohet shkakton rrëshqitjen e diskut në volan		Saktë
1288	Pedali i friksionit kontrollon satelitët e diferencialit		Gabim
1289	Pedali i friksionit komandon kushinetën e friksionit		Saktë
1290	Pedali i friksionit duhet të lëshohet gradualisht		Gabim
1291	Pedali i friksionit mund të komandojë kushinetën me anë të pajisjeve hidraulike		Saktë
1292	Pedali i friksionit mund të komandojë kushinetën me anë të pajisjeve mekanike		Saktë
1293	Pedali i friksionit mund të komandojë kushinetën me anë të pajisjeve pneumatike		Saktë
1294	Pedali i friksionit mund të lëshohet papritmas nga shoferi kur niseni		Gabim
1295	Gjatë drejtimit të mjetit, në mënyrë që të shpejtoni ndërrimin e marsheve, duhet ta mbështesni këmbën gjithmonë mbi pedalin e friksionit		Gabim
1296	Komandimi hidraulik i friksionit zvogëlon forcën e ushtruar mbi pedale nga drejtuesit		Saktë
1297	Komandimi hidraulik i friksionit përmirëson qëndrueshmërinë e automjetit gjatë kthesës		Gabim
1298	Komandimi hidraulik i friksionit përdor presionin e ajrit për të zvogëluar forcën ushtruar mbi pedale të drejtuesit		Gabim
1299	Komandimi hidraulik i friksionit përdor presionin e vajit të motorit për të zvogëluar forcën ushtruar mbi pedale të drejtuesit		Gabim
1300	Komandimi hidraulik i friksionit përdor presionin e vajit për të zvogëluar forcën ushtruar nga drejtuesi mbi pedale		Saktë
1301	Gjatë muajve të dimrit ekziston rreziku që friksioni të bllokohet për shkak të formimit të akullit brenda tij		Gabim
1302	Kur automjeti është në lëvizje, friksioni shkëputet nga volani		Gabim
1303	Në të gjitha automjetet ka një pedale friksioni		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1304	Në tatëpjetë (zbritje) është mirë të udhëtoni me pedalin e friksionit të shtypur për të kursyer karburant		Gabim
1305	Mbingarkesa e automjetit rrit konsumin e friksionit		Saktë
1306	Në përgjithësi, automjetet e rënda janë me rrota aktive të përparme		Gabim
1307	Kutia e shpejtësisë përmban vaj lubrifikues i cili duhet të zëvendësohet periodikisht		Saktë
1308	Kutia e shpejtësisë përmban vaj lubrifikues, niveli i të cilit duhet të kontrollohet periodikisht		Saktë
1309	Kutia e shpejtësisë (kambio) shërben për të ndryshuar shpejtësinë e lëvizjes së mjetit, sipas kushteve rrugore e të qarkullimit dhe për lëvizje të mjetit prapa		Saktë
1310	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale) me levën e marsheve në pozicion neutral (afoljo), kur motori është i ndezur, shkëput xhirot për në transmision		Saktë
1311	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale) merr lëvizjen nga friksioni dhe ja jep transmisionit kardanik		Saktë
1312	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale) transmeton lëvizjen në friksion		Gabim
1313	Kutia e shpejtësisë me ingranazhe (kambio manuale) shërben vetëm për të ndryshuar shpejtësinë e lëvizjes		Gabim
1314	Në marshin e parë, numri i rrotullimeve që dalin nga kutia e shpejtësisë është më i ulët se numri i rrotullimeve të boshtit motorik		Saktë
1315	Në marshin e parë, numri i rrotullimeve që dalin nga kutia e shpejtësisë është më i lartë se numri i rrotullimeve të boshtit motorik		Gabim
1316	Kutia e shpejtësisë përmban vaj lubrifikues në të cilin ingranazhet janë zhytur pjesërisht		Saktë
1317	Kutia e shpejtësisë e automjeteve elektrike në përgjithësi ka më shumë raporte shpejtësie sesa ajo e vendosur në automjetet me motorë me djegie të brendshme		Gabim
1318	Kutia e shpejtësisë vendoset midis boshtit me gunga dhe friksionit		Gabim
1319	Kutia e shpejtësisë është një mekanizëm që lejon që rrotat të rrotullohen më shpejt se boshti motorik		Gabim
1320	Kutia e shpejtësisë nuk ka kurrë dy marshe me të njëjtin numër xhirosh rpm		Saktë
1321	Kutia e shpejtësisë nuk ka kurrë më shumë se 6 marshe		Gabim
1322	Kutia e shpejtësisë lejon që një forcë e ndryshueshme të transmetohet në rrota në varësi të marshit të ingranuar		Saktë
1323	Kutia e shpejtësisë shërben për të mbajtur konstante shpejtësinë e rrotullimit të boshtit të kardanik, pavarësisht nga numri i rrotullimeve të motorit		Gabim
1324	Kutia e shpejtësisë përdoret për të ndryshuar raportin midis rrotullimeve të motorit dhe rrotullimeve të boshtit të transmetimit dhe rrjedhimisht, të rrotave lëvizëse		Saktë
1325	Këmba e majtë e drejtuesit, kur ai nuk vepron për të ndryshuar marshin, nuk duhet të mbështetet në pedalin e friksionit		Saktë
1326	Sinkronizuesi është një pajisje që është pjesë e kutisë së shpejtësisë dhe që lejon që boshti me gunga dhe boshti i transmetimit të rrotullohen me të njëjtën shpejtësi		Gabim
1327	Sinkronizuesi është një pajisje që lehtëson bashkimin e ingranazheve të kutisë së shpejtësisë kur ndryshoni nga një marsh në tjetrin		Saktë
1328	Sinkronizuesi e bën më të lehtë dhe më të qetë bashkimin e ingranazheve të kutisë së shpejtësisë		Saktë
1329	Ndonjëherë ngadalësuesi i shpejtësisë mund të vendoset në dalje të kutisë së shpejtësisë		Saktë
1330	Kalimi në një marsh ingranimi më të lartë rrit shpejtësinë e motorit		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1331	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) përbëhet nga mekanizma që realizojnë ndryshim të pa shkallëzuar të momentit përdredhës		Saktë
1332	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) ka boshtin primar që është i lidhur me turbinën e friksionit hidraulik		Saktë
1333	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) realizon nisje të qetë të mjetit nga vendi		Saktë
1334	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) nuk ka nevojë për vajosje		Gabim
1335	Kutia e shpejtësisë automatike (kambio automatike) komandohet me pedal me këmbën e majtë		Gabim
1336	Funksioni i kutisë së ndërrimit të shpejtësisë është të modifikojë fuqinë që mund t'i jepet rrotave për të mposhtur më lehtë rezistencën kur ecni përpara		Saktë
1337	Mjetet e pajisura me një transmision automatik janë përgjithësisht me katër rrota aktive		Gabim
1338	Kutitë e ndërrimit të shpejtësisë automatike mund të kenë një maksimum prej 5 marshesh		Gabim
1339	Transmisioni kardanak transmeton lëvizjen nga kutia e shpejtësisë te çifti pinjon-koronë i diferencialit		Saktë
1340	Transmisioni kardanak mundëson transmetimin e lëvizjen në kënde dhe distancë të ndryshueshme, gjatë lëvizjes së mjetit		Saktë
1341	Transmisioni kardanak, në mjetet me gjatësi të mëdha, mund të përbëhet nga dy boshte		Saktë
1342	Transmisioni kardanak duhet të jetë sa më i rëndë që të transmetojë mirë lëvizjen		Gabim
1343	Transmisioni kardanak ka si pjesë përbërëse dhe reduktuesin e shpejtësisë (ridoton)		Gabim
1344	Transmisioni kardanak transmeton lëvizjen nga friksioni në kutinë shpejtësisë		Gabim
1345	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) shërben për të dhënë lëvizjen diferencialit nga transmisioni kardanak		Saktë
1346	Boshti kardanak i transmetimit duhet të jetë shumë i tensionuar për të parandaluar lëkundjen e diferencialit		Gabim
1347	Boshti kardanak i transmetimit nuk është i pranishëm nëse automjeti ka aktive rrotat e pasme dhe motorin të pozicionuar në pjesën e përparme		Gabim
1348	Boshti kardanak i transmetimit nuk është i pranishëm nëse automjeti nëse automjeti ka aktive rrotat e pasme dhe motorin të pozicionuar në pjesën e pasme		Saktë
1349	Boshti motorik dhe boshti kardanak i transmetimit janë dy emra të ndryshëm për të njëjtin element të automjetit		Gabim
1350	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) ka në përbërje pinjonin, i cili e merr lëvizjen nga transmisioni kardanak		Saktë
1351	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) merr lëvizjen nga diferenciali dhe ja transmeton tek semiakseve		Gabim
1352	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) shërben për të rritur ose për të zvogëluar shpejtësinë e lëvizjes së mjetit në rrugë		Gabim
1353	Transmisioni kryesor (çifti pinjon-koronë) është pjesë e boshtit motorik		Gabim
1354	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) realizon ingranimin e saktë ndërmjet dhëmbëve të pinjonit me atë të koronës		Saktë
1355	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) bëhet nëpërmjet regjistrimit të kushinetave konike të pinjonit		Saktë
1356	Çifti koronë pinjon mund të montohet në vend të diferencialit		Gabim
1357	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) bëhet në servise të specializuara		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1358	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) kërkon regjistrimin e vetëm të njëjës kushinetës të koronës		Gabim
1359	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) realizohet nga drejtuesi i mjetit, gjatë lëvizjes së mjetit		Gabim
1360	Regjistrimi i transmisioni kryesor (çiftit pinjon-koronë) nuk bëhet në asnjë rast, por vetëm ndërrohet çifti pinjon-koronë		Gabim
1361	Diferenciali ndryshon xhirot në rrotat aktive gjatë lëvizjes së mjetit në kthesa		Saktë
1362	Diferenciali ju lejon të ruani tërheqjen optimale të automjetit edhe në terrene me kapje (aderencë) të dobët të gomës		Gabim
1363	Diferenciali përmban vaj lubrifikues i cili duhet të zëvendësohet periodikisht		Saktë
1364	Diferenciali është një mekanizëm që parandalon rrëshqitjen e rrotave gjatë kthesës		Saktë
1365	Diferenciali është një mekanizëm që lejon rrotat e jashtme dhe të brendshme të rrotullohen me të njëjtën shpejtësi, gjatë kthesës		Gabim
1366	Diferenciali është një ndarës midis rrotave lëvizëse të të njëjtit aks		Saktë
1367	Diferenciali lejon që rrotat e makinës të kenë shpejtësi të ndryshme në raport me njëra - tjetrën		Saktë
1368	Diferenciali transmeton lëvizje në rrota përmes dy gjysmë boshteve (semiakseve)		Saktë
1369	Gjatë një kthese, diferenciali lejon të transferohet një pjesë të shpejtësisë së rrotullimit nga rrota e jashtme në atë të brendshme		Gabim
1370	Gjatë një kthese, diferenciali lejon të transferohet një pjesë të shpejtësisë së rrotullimit nga rrota e brendshme në atë të jashtme		Saktë
1371	Diferenciali transmeton lëvizjen në rrota me anë të semiakseve		Saktë
1372	Diferenciali punon në ambient lubrifikanti		Saktë
1373	Planetarët janë ingranazhe të diferencialit, që lidhen me semiakset nëpërmjet shlicave		Saktë
1374	Ingranazhet satelit të diferencialit, të ingranuar me ingranazhet planetar, kryejnë rrotullime rreth aksit të tyre, kur mjeti lëviz në kthesa		Saktë
1375	Lëvizja në diferencial transmetohet nga çifti pinjon-koronë		Saktë
1376	Diferenciali e merr lëvizjen nga semiakset		Gabim
1377	Diferenciali mund të jetë me një ose dy planetarë		Gabim
1378	Diferenciali shërben për ndryshimin e shpejtësisë së lëvizjes së mjetit		Gabim
1379	Bllokazhi i diferencialit përdoret në rast xhirimi të njëjës prej rrotave aktive, në baltë apo akull		Saktë
1380	Bllokazhi i diferencialit kur vihet në punë realizon lidhjen e dy semiakseve		Saktë
1381	Bllokazhi i diferencialit i vënë në funksionim bllokon rrotullimin e satelitëve, rreth aksit të tyre		Saktë
1382	Bllokazhi i diferencialit përdoret në lëvizje normale me mjet dhe në rrugë të asfaltuar me kthesa		Gabim
1383	Bllokazhi i diferencialit i vënë në funksionim bllokon rrotullimin e planetarëve dhe semiakseve		Gabim
1384	Bllokazhi i diferencialit përdoret në të gjitha automjetet		Gabim
1385	Ndërprerja e lëvizjes në rrotat aktive mund të shkaktohet nga prishja e mekanizmit të komandimit të friksionit		Gabim
1386	Ndërprerja e lëvizjes në rrotat aktive mund të shkaktohet nga rënia e nivelit të vajit në kutinë e shpejtësisë		Gabim
1387	Automjetet me rrota të pasme aktive duhet domosdoshmërisht të kenë një motor të vendosur përpara		Gabim
1388	Automjetet me 4 rrota aktive nuk kanë friksion		Gabim
1389	Automjetet me akse drejtuese të dyfishta janë të pajisura me dy friksione të veçanta		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
1390	Në përgjithësi, automjetet e rënda janë me rrota aktive të përparme		Gabim
1391	Motorët me djegie të brendshme kthejnë energjinë termike, në energji mekanike		Saktë
1392	Motori me djegie të brendshme që furnizon automjetet me energji duke transformuar energjinë mekanike në energji termike		Gabim
1393	Motori me djegie të brendshme punon duke thithur dhe ngjeshur vetëm ajrin		Gabim
1394	Energjia e nevojshme për funksionimin e motorit sigurohet nga përzierja e duhur e ajrit me lëndën djegëse që më pas ndizet		Saktë
1395	Motorët me djegie të brendshme shndërrojnë forcën lëvizëse në nxehtësi		Gabim
1396	Gjatë funksionimit të një motori, nxehtësia që nuk transformohet në energji mekanike transferohet në pjesën e jashtme, përmes sistemit të ftohjes, për të shmangur mbinxhjen		Saktë
1397	Në një motor me djegie të brendshme, përzierja benzinë-ajër ndodh në rezervuarin e karburantit		Gabim
1398	Motorët me ndezje të detyruar me benzinë dhe motorët me naftë janë të dy motorë me djegie të brendshme		Saktë
1399	Motorët me benzinë janë motorë me ndezje të detyruar		Saktë
1400	Fuqia e një motori tregohet në volt		Gabim
1401	Fuqia e një motori tregon punën e bërë në njësinë e kohës		Saktë
1402	Konsumi specifik i një motori përfaqëson sasinë e karburantit të kërkuar për të prodhuar një njësi të fuqisë		Saktë
1403	Në lartësi, ku presioni i ajrit është më i ulët, efikasiteti i motorit zvogëlohet, veçanërisht nëse është i tipit me djegie të brendshme		Gabim
1404	Në një lartësi, ku presioni i ajrit është më i ulët, efikasiteti i motorit zvogëlohet, veçanërisht nëse është i tipit Diesel		Gabim
1405	Në automjete përdoren kryesisht motorë me djegie të brendshme me katër kohë		Saktë
1406	Motorët me djegie të brendshme janë vetëm me dy kohë		Gabim
1407	Motorët me djegie të brendshme janë vetëm me një cilindër		Gabim
1408	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij mekanizmin bjellë-manivelë		Saktë
1409	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij sistemin e shpërndarjes së gazrave, i cili komandon futjen e ajrit dhe daljen e gazrave të djegies		Saktë
1410	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij sistemin e vaisjes		Saktë
1411	Motori me djegie të brendshme është i pajisur edhe me sistemin e ftohjes		Saktë
1412	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij friksionin		Gabim
1413	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij mekanizmat e transmetimit të lëvizjes		Gabim
1414	Motori me djegie të brendshme ka në përbërje të tij kutinë e shpejtësisë		Gabim
1415	Në motorin diesel me katër kohë, gjatë thithjes në cilindër hyn ajër i pastër nga valvola e thithjes		Saktë
1416	Në motorin diesel me katër kohë, lënda djegëse sprucohet me presion në dhomën e djegies dhe vetëndizet		Saktë
2544	Paqëndrueshmëria e drejtimit të autobusit mund të shkaktohet nga shkarkimi i amortizatorëve		Saktë
2545	Kur sistemi i shuarjes së lëkundjeve nuk funksionon mirë sjell paqëndrueshmëri në drejtimin e autobusit		Saktë
2546	Mosfunksionimi i sistemit të navigimit sjell paqëndrueshmërinë e drejtimit të autobusit		Gabim
2547	Përdorimi i gomave dimërore në një ditë kur temperatura e asfaltit është rreth 25 ° C sjell paqëndrueshmërinë e drejtimit të autobusit		Gabim
2548	Balestrat dhe sustat e dëmtuara sjellin paqëndrueshmëri në drejtimin e autobusit		Saktë
2549	Bllokimi i filtrit të karburantit sjell nxjerrjen e tymit me ngjyrë të verdhë nga tubi i shkarkimit		Gabim
2550	Bllokimi i filtrit të karburantit çon në vajosje të pamjaftueshme të cilindrave të motorit		Gabim
2551	Bllokimi i filtrit të karburantit çon në konsum më të lartë		Saktë
2552	Bllokimi i filtrit të karburantit sjell presion më të lartë të injektimit të naftës		Gabim
2553	Bllokimi i filtrit të karburantit sjell humbjen e fuqisë së motorit		Saktë
2554	Bllokimi i filtrit të karburantit sjell rritje të presionit të naftës në pompë		Gabim
2555	Ligji përcakton që mirëmbajtja dhe shërbimet e autobusëve duhet të kryhet ekskluzivisht nga autoservise të regjistruara në një regjistër specifik		Saktë
2556	Ligji përcakton që mirëmbajtja dhe shërbimet e autobusëve duhet të kryhet ekskluzivisht nga autoservise të regjistruara për të shmangur aksidentet për shkak të punimeve të mirëmbajtjes ose riparimeve të pasakta		Saktë
2557	Ligji përcakton që mirëmbajtja dhe shërbimet e autobusëve duhet të kryhet ekskluzivisht nga autoservise të regjistruara në mënyrë që të garantohej asgjësimi i saktë i mbetjeve për shkak të këtyre aktiviteteve		Saktë
2558	Ligji përcakton që zëvendësimi i amortizatorëve duhet të kryhet nga drejtuesi i autobusit në serviset e autorizuara		Gabim
2559	Ligji përcakton që zëvendësimi i filtrit të ajrit, është pjesë e shërbimeve parandaluese dhe duhet të kryhet nga drejtuesi i autobusit		Saktë
2560	Ligji përcakton që zëvendësimi i filtrit të vajit është pjesë e shërbimeve parandaluese dhe duhet të kryhet nga drejtuesi i autobusit		Saktë
2561	Ligji përcakton që zëvendësimi i lëngut ftohës të motorit është pjesë e shërbimeve parandaluese dhe duhet të kryhet nga drejtuesi i autobusit		Saktë
2562	Nëse uji ose lëngu futet në radiator kur motori është shumë i nxehtë, ekziston rreziku i plasaritjes së bllokut të cilindrit ose i deformimit të kokës së motorit		Saktë
2563	Ndërrimi i lëngut ftohës të motorit shoqërohet me ndërrimin e detyrueshëm të valvoles termostat		Gabim
2564	Presioni i pamjaftueshëm i fryrjes së gomave sjell rritjen e temperaturës së lëngut ftohës të motorit		Gabim
2565	Nëse udhëton natën, drejtuesi duhet të sigurohet që të ketë në bord dy rezervuarë nga 25 litra me karburant rezervë përpara se të nisët		Gabim
2566	Të gjitha riparimet në lidhje me kutinë e shpejtësisë duhet të kryhen në një autoservis të autorizuar dhe nga personel i kualifikuar		Saktë
2567	Mirëmbajtja që drejtuesi është i autorizuar të kryejë përfshin zëvendësimin ose pastrimin e filtrave të ajrit dhe vajit		Saktë
2568	Nëse automjeti ka vështirësi në ndezje, drejtuesi mund të lidhë dy polet e baterisë së bashku me kabllon elektrike speciale për ta ndihmuar atë		Gabim



**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

Nr.	Përmbajtja	Figura	Përgjigja
<b>TEMA XVI : PËRGJEGJSHMËRIA NDAJ UDHËTARËVE QË TRANSPORTOHEN. KOMODITETIN DHE SIGURINË E PASAGJERËVE, TRANSPORTIN E FËMIJËVE DHE KONTROLLET E NEVOJSHME PARA NISJES</b>			
2569	Një ndër kushtet që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është të sigurojnë komoditetin në udhëtim të udhëtarëve		Saktë
2570	Një ndër kushtet e komoditetit që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është të jenë pajisur me sistemin e hapjes dhe të mbylljes së derve, me komandim nga drejtuesi i mjetit		Saktë
2571	Një ndër kushtet që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është që dera ose dritarja e emergjencës të jenë funksionale, për të evituar rreziqet		Saktë
2572	Një ndër kushtet e komoditetit që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është që dyert duhet të kenë mundësi hapje nga udhëtarët në raste defektesh, aksidentesh apo në pamundësi komandimi nga drejtuesi i mjetit		Saktë
2573	Autobusët, për transportin e udhëtarëve, duhet të kenë të instaluar kompletin e pajisjeve për situata emergjente (fikse zjarri, çekiç për thyerje xhamash etj.) sipas manualit të prodhuesit		Saktë
2574	Autobusët, të cilët kryejnë transportin e udhëtarëve në linjat ndërqytetëse, përveç derës së drejtuesit të autobusit duhet të kenë minimalisht dy dyer (përfshirë daljen e emergjencës)		Saktë
2575	Autobusët, të cilët kryejnë transportin e udhëtarëve në linjat ndërqytetëse, përveç derës së drejtuesit të autobusit duhet të kenë minimalisht tre dyer, (përfshirë daljen e emergjencës)		Gabim
2576	Autobusët e transportit ndërkombëtar dhe brenda vendit të udhëtarëve, në linja të rregullta, si dhe në shërbimet e transportit të rastit/turistik të udhëtarëve, duhet të jenë të pajisur me qendër zëri		Saktë
2577	Autobusët e transportit ndërkombëtar dhe brenda vendit të udhëtarëve, në linja të rregullta, si dhe në shërbimet e transportit të rastit/turistik të udhëtarëve, duhet të kenë tualet (WC, lavaman të vogël dhe solucion pastrimi)		Saktë
2578	Një ndër kushtet që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është të jenë të pajisur vetëm me kambio automatike		Gabim
2579	Kushti i vetëm i komoditetit që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është që të kenë pamje të jashtme e të brendshme estetike		Gabim
2580	Një ndër kushtet që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është të jenë prodhuar jo më shumë se pesë vjet e fundit		Gabim
2581	Një ndër kushtet që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është të kenë përshkuar më pak se 50 mijë kilometra		Gabim
2582	Kushti i vetëm që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është vetëm pajisja e tyre me kutinë e ndihmës së shpejtë dhe fiksen e zjarrit		Gabim
2583	Një ndër kushtet që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është që detyrimisht dyert e autobusëve interurbane të kenë të shënuar “HYRJE” dhe “DALJE”		Gabim
2584	Një ndër kushtet që duhet të plotësojnë autobusët, për transportin e udhëtarëve, është që brenda autobusit të jetë i shënuar numri i vendeve të ulura dhe jo numri maksimal i udhëtarëve që mund të transportohen		Gabim
2585	Për autobusët e shërbimit urban kontrolli teknik kryhet një herë në vit		Saktë
2586	Për autobusët që kryejnë transporte për llogari të vetë kontrolli teknik kryhet një herë në vit		Saktë
2587	Kontrolli teknik kryhet, çdo tre muaj, për autobusët e shërbimit urban		Gabim
2588	Kontrolli teknik kryhet, çdo tre muaj, për autobusët e transportit ndërkombëtar		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
2589	Kontrolli teknik kryhet, një herë në vit, për autobusët që kryejnë shërbime të rastit		Saktë
2590	Pasagjerët në autobus, nuk duhet t'i zvogëlojnë fushëpamjen drejtuesit të mjetit		Saktë
2591	Pasagjerët në autobus, nuk duhet të pengojnë lirshmërinë e lëvizjeve të drejtuesit gjatë drejtimit të mjetit		Saktë
2592	Numri i udhëtarëve në autobus, nuk duhet të kalojë numrin maksimal të shënuar në lejen e qarkullimit		Saktë
2593	Në autobus lejohet të udhëtojnë deri në 3 persona më shumë se ai i përcaktuar në lejen e qarkullimit		Gabim
2594	Pasagjerët në autobus, lejohet të jenë deri 5 % mbi numrin e përcaktuar në lejen e qarkullimit		Gabim
2595	Drejtuesi i autobusit për shërbim të transportit ndërqytetës, para nisjes duhet të udhëzojë udhëtarët që të ulen në vendin e shënuar në biletë		Saktë
2596	Drejtuesi i autobusit për shërbim të transportit ndërqytetës, duhet të kontrollojë vazhdimisht që të mos ketë gjatë udhëtimit pasagjerë në këmbë		Saktë
2597	Drejtuesi i autobusit, para fillimit të ditës së punës, duhet të kujdeset që autobusi të jetë larë e pastruar mirë		Saktë
2598	Drejtuesi i autobusit për shërbim të transportit ndërqytetës, duhet të ruajë mundësisht një shpejtësi të njëtrajtshme lëvizjeje		Saktë
2599	Drejtuesi i autobusit për shërbim të transportit ndërqytetës, duhet të njoftojë udhëtarët vetëm për pjesët e rrezikshme të rrugës		Gabim
2600	Drejtuesi i autobusit për shërbim të transportit ndërqytetës, duhet të njoftojë udhëtarët për kohën e pushimit		Saktë
2601	Drejtuesi i autobusit për shërbim të transportit ndërqytetës duhet të kryejë frenime të shpeshta dhe të menjëhershme		Gabim
2602	Drejtuesi i autobusit urban, duhet të sigurohet për hapjen e mbylljen e rregullt të dyerve		Saktë
2603	Drejtuesi i autobusit për transport qytetës duhet të mos e nisë autobusin, pa u siguruar për zbritjen e të gjithë udhëtarëve		Saktë
2604	Drejtuesi i autobusit për transport qytetës duhet të realizojë një ndalim sa më të butë të autobusit në stacionet e qëndrimit		Saktë
2605	Drejtuesi i autobusit për transport qytetës duhet të realizojë nisje sa më të shpejtë të mjetit nga vendi		Gabim
2606	Drejtuesi i autobusit, gjatë udhëtimit, duhet të sigurojë një komfort të përshtatshëm për udhëtarët, gjatë kalimit nëpër kthesa, nëpërmjet një shpejtësie të përshtatshme në raport me rezen e kthesës		Saktë
2607	Drejtuesi i autobusit, gjatë udhëtimit, duhet të sigurojë një komfort të përshtatshëm për udhëtarët, nëpërmjet një shpejtësie sa më uniforme		Saktë
2608	Drejtuesi i autobusit, gjatë udhëtimit, duhet të sigurojë një komfort të përshtatshëm për udhëtarët, nëpërmjet përshpejtimit dhe frenimit sa më gradual		Saktë
2609	Drejtuesi i autobusit, gjatë udhëtimit, duhet të mos bisedojë me udhëtarë ose persona të tjerë		Saktë
2610	Drejtuesi i autobusit, gjatë udhëtimit, duhet të sigurojë një komfort të përshtatshëm për udhëtarët, duke eliminuar frenimin		Gabim
2611	Gjatë udhëtimit, drejtuesi i autobusit duhet të rrisë shpejtësinë e mjetit, në kthesat me reze të vogël, për të zvogëluar forcën centrifugale		Gabim
2612	Drejtuesi i autobusit për shërbim të transportit ndërqytetës, gjatë udhëtimit, duhet të ndërpresë shërbimin me iniciativën e vet, nëse e shikon të nevojshme		Gabim
2613	Drejtuesi i autobusit duhet të mbajë automjetin pastër dhe në gjendje të mirë teknike		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
2614	Drejtuesi i autobusit duhet të respektojë orarin e mbërritjes në ndalesat në stacionet e përcaktuara		Saktë
2615	Drejtuesi i autobusit mund të përdorë pajisjet qendrore të komunikimit në situata emergjente		Saktë
2616	Drejtuesi i autobusit, para se të niset, duhet të kontrollojë nëse dyert janë të mbyllura		Saktë
2617	Drejtuesi i autobusit në pushimin gjatë shërbimit, mund të hajë ushqim ose të pijë duhan në bordin e autobusit,		Gabim
2618	Drejtuesi i autobusit gjatë shërbimit mund të mbajë dyert hapur, nëse temperatura e jashtme është e lartë edhe kur mjete është në lëvizje		Gabim
2619	Drejtuesi i autobusit duhet të marrë parasysh kërkesën e disa udhëtarëve, për të qëndruar jashtë stacioneve të planifikuara		Gabim
2620	Drejtuesi i autobusit duhet të sillet me integritet, qytetari dhe përgjegjshmëri në çdo rrethanë		Saktë
2621	Drejtuesi i autobusit duhet të garantojë sigurinë dhe qetësinë e udhëtarëve		Saktë
2622	Drejtuesi i autobusit, gjatë ngjitjes dhe zbritjes së udhëtarëve në autobus, duhet të pozicionohet në mënyrë të sigurtë në stacion		Saktë
2623	Drejtuesi i autobusit për transport qytetës, gjatë ngjitjes dhe zbritjes së udhëtarëve, duhet të evitohet kryerjen e veprimeve, që nuk lidhen direkt me punën e tij		Saktë
2624	Drejtuesi i autobusit për transport qytetës duhet të mos lejojë qëndrimin në këmbë të udhëtarëve		Gabim
2625	Drejtuesi i autobusit, gjatë ngjitjes dhe zbritjes së udhëtarëve duhet të mbajë hapur edhe dyert e emergjencës		Gabim
2626	Drejtuesi i autobusit duhet të hapë edhe daljet e sigurisë, gjatë ndalimit të autobusit		Gabim
2627	Autobusët duhet të kenë daljet emergjente me sinjalistikë të përshtatshme		Saktë
2628	Në autobusë me hapësirat e rezervuara për karriget me rrota duhet të pajisen me sisteme bllokuese të tyre		Saktë
2629	Në autobusë, me hapësirat e rezervuara për karriget me rrota nuk duhet të pajisen me sisteme bllokuese të tyre		Gabim
2630	Drejtuesit e autobusit që ngasin më shumë se 7 orë në ditë përjashtohen nga përdorimi i rripit të sigurimit		Gabim
2631	Si rregull, rripat e sigurimit nuk janë të detyrueshëm në autobusët e kategorisë M3		Gabim
2632	Gjatë udhëtimit, drejtuesit të autobusit i kërkohet të kontrollojë funksionimin e të gjitha pajisjeve të ndriçimit dhe sinjalizimit vizual gjatë gjithë kohës, duke iu referuar veçanërisht pajisjeve të ndriçimit të daljeve të shërbimit		Gabim
2633	Gjatë udhëtimit, drejtuesi i autobusit për shërbim të transportit ndërqtetës duhet të vendosë rripat e sigurimit, nëse mjete është i pajisur me to		Saktë
2634	Gjatë udhëtimit, të gjithë pasagjerët mbi 3 vjeç të autobusëve pa vendqëndrime të caktuara, duhet të mbajnë sisteme të përshtatshme mbajtëse, nëse mjete është i pajisur me to		Saktë
2635	Gjatë stinës së dimrit, shuarset e zjarrit në autobusë mund të mbahen brenda bagazhit		Gabim
2636	Drejtuesi i autobusit duhet të kontrollojë periodikisht efikasitetin e rripave të sigurimit në automjet		Saktë
2637	Inspektimi i aparateve të zjarrit në autobusë duhet të vërtetohet nga drejtuesi i mjetit		
2638	Përdorimi i rripave të sigurimit nuk është gjithmonë i detyrueshëm për pasagjerët e autobusëve në shërbimin ndërqtetës, edhe nëse ata janë të pajisur me to		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
2639	Personat që vuajnë nga sëmundje të veçanta, përderisa janë të certifikuar siç duhet, nuk janë të detyruar të vendosin rripin e sigurimit		
2640	Drejtuesi i mjetit duhet t'u kujtojë pasagjerëve detyrimin për të vendosur rripat e sigurimit		Saktë
2641	Autobusi për shërbim të transportit ndërqytetës nuk mund të kenë vende qëndrimi në këmbë		Saktë
2642	Autobusi për shërbim të transportit rrethqytetës nuk mund të kenë vende qëndrimi në këmbë		Gabim
2643	Autobusët duhet të jenë të pajisur me gjashtë shuarse zjarri në rast se nuk kanë dalje emergjente		Gabim
2644	Autobusët zakonisht janë të pajisur me të paktën 3 dyer dhe dalje emergjente		Gabim
2645	Autobusët zakonisht janë të pajisur me dyer dhe dalje emergjente		Saktë
2646	Autobusët zakonisht janë të pajisur me testues alkooli për pasagjerët		Gabim
2647	Fikëset e zjarrit të autobusit duhet të ndërrohen kur automjeti kryen kontrollin teknik		Gabim
2648	Fikëset e zjarrit në autobusë duhet të jenë të tipit të miratuar		Saktë
2649	Fikëset e zjarrit në autobusë mund të jenë vetëm të llojit shumë		Gabim
2650	Inspektimi i aparateve zjarrfikëse të pranishme në autobusë nga një kompani e specializuar duhet të vërtetohet me një shënim të vendosur në një pllakë të veçantë të fiksuar në vetë aparatin zjarrfikës		Saktë
2651	Inspektimi i aparateve të zjarrit në autobusë duhet të vërtetohet nga drejtuesi i mjetit		Gabim
2652	Rripat e sigurimit të autobusit nuk i nënshtrohen miratimit të tipit		Gabim
2653	Rripat e sigurimit duhet të vendosen vetëm nëse udhëtoni me shpejtësi të barabartë ose më të madhe se 30 km/h		Gabim
2654	Gratë shtatzëna me kushte të veçanta rreziku, për sa kohë që ato janë të certifikuara siç duhet, nuk janë të detyruara të vendosin rripat e sigurimit		Saktë
2655	Personat që vuajnë nga sëmundje të veçanta, përderisa janë të certifikuar siç duhet, nuk janë të detyruar të vendosin rripin e sigurimit		Saktë
2656	Personave mbi 65 vjeç nuk u kërkohet të vendosin rripat e sigurimit		Gabim
2657	Për komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që autobusët të kenë pamje të jashtme dhe të brendshme estetike, të jenë të lyer, pa njolla dhe pa deformime apo shtypje		Saktë
2658	Për komoditetin e udhëtimit me autobus për shërbim të transportit ndërqytetës duhet që dritaret të jenë funksionale, me xhama origjinalë, me korniza gome dhe me mbrojtëse nga dielli si: perde, grila etj.		Saktë
2659	Për komoditetin e udhëtimit me autobus për transportin ndërkombëtar duhet që sediljet të jenë komode, të veshura, me sistem rregullimi dhe të kenë pajisje bllokuese funksionale		Saktë
2660	Për komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që dyshemeja, tavani dhe paretet anësore, të jenë të veshura, në gjendje teknike për të siguruar hermeticitetin e nevojshëm nga faktorët e jashtëm		Saktë
2661	Për komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që ndriçimi i brendshëm të përdoret, vetëm në autobusët e linjave ndërqytetëse		Gabim
2662	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që në autobus mund të qëndrojnë në këmbë, vetëm nëse përcaktohet në lejen e qarkullimit		Saktë
2663	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që nëse lejohet, udhëtarët që janë në këmbë duhet të shpërndahen uniformisht në korridor ose në hapësirat e parashikuara		Saktë
2664	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që normalisht, udhëtarët të qëndrojnë të mbështetur në mënyrën e duhur, për shkak të frenimit papritur (në rastin e udhëtimit në këmbë)		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
2665	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që si rregull, udhëtarët të mos bllokojnë dyert e autobusit për të lejuar udhëtarët e tjerë të lëvizin lirisht		Saktë
2666	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus për transport ndërqytetës duhet që udhëtarët të qëndrojnë në këmbë, nëse ka hapësirë të lirë në korridor		Gabim
2667	Nëse në autobusët e shërbimit urban udhëtojnë persona me aftësi të kufizuar në karrige me rrota, ata duhet të qëndrojnë pranë derës së përparme		Gabim
2668	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që udhëtarët në këmbë, të jenë të përqendruar në pjesën e pasme të automjetit		Gabim
2669	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që si rregull, udhëtarët të pastrojnë ndenjëset e automjetit		Gabim
2670	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që autobusët të jenë mjete origjinale, të prodhuar për transport udhëtarësh		Saktë
2671	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që dera ose dritarja e emergjencës të jetë funksionale		Saktë
2672	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që udhëtarët të informohen për pozicionin dhe mënyrën e përdorimit të derës ose dritares së emergjencës, nëpërmjet mbishkrimeve të treguara mbi to		Saktë
2673	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që butoni i hapjes së dyerve nga ana e udhëtarëve, të jetë i vendosur në një vend të dallueshëm		Saktë
2674	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që kur dera apo dritarja e emergjencës nuk funksionojnë, drejtuesi i mjetit të niset pasi i ka njoftuar udhëtarët për këtë		Gabim
2675	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që dyert e shërbimit të jenë me hapje të komanduar, vetëm nga drejtuesi i mjetit		Gabim
2676	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që vetëm autobusët e transportit ndërkombëtar, të jenë të pajisur me kondicionerë		Gabim
2677	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që në autobus të vendoset tabela "Mos i fol shoferit"		Saktë
2678	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që të mos lejohet në ambientin e brendshëm të autobusit, vendosja e sendeve, mallrave që bëhen pengesë për qarkullimin e lirë të udhëtarëve		Saktë
2679	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që pozicioni i ndenjës së drejtuesit të mjetit, lartësia dhe largësia e saj nga udhëtarët si dhe pozicionet dhe largësitë e ndenjësive të udhëtarëve kundrejt tyre të jenë sipas standardeve		Saktë
2680	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që mallrat e rrezikshme, të lejohen në ambientin e brendshëm të autobusit, vetëm me dijeninë e drejtuesit të mjetit		Gabim
2681	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që dyshemeja e çarë e autobusit të jetë e mbuluar me tapet që të mos hyjë shumë pluhur		Gabim
2682	Për sigurinë dhe komoditetin e udhëtimit me autobus duhet që materialet rrëshqitëse, pajisjet apo veglat e punës, të lejohen në ambientin e brendshëm të autobusit, vetëm me dijeninë e drejtuesit të mjetit		Gabim
2683	Mjet i vlefshëm për transportin shkollor është automjeti që plotëson kushtet dhe rregullat e përcaktuara ligjërisht		Saktë
2684	Mjet i vlefshëm për transportin shkollor është çdo mjet transporti, mjafton që të jetë përshtatur nga të interesuarit për transport udhëtarësh		Gabim
2685	Mjet i vlefshëm për transportin shkollor është edhe çdo mjet me 4+1 vende, nëse i përket një shoqërie transporti me taksì, e cila merr përsipër një transport të tillë		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
2686	Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve kryhet përmes shërbimit të rregullt të specializuar		Saktë
2687	Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve mund të kryhet edhe nëpërmjet operacioneve të transportit për llogari të vet		Saktë
2688	Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve kryhet edhe nëpërmjet shërbimeve të rastit, vetëm për parauniversitarët dhe studentët		Saktë
2689	Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve kryhet me mjet për transportet e rastit me dyer të mbyllura, qe transporton një ose më shumë grupe të formuar më parë		Gabim
2690	Shërbimet e rregullta të specializuara janë shërbimet që sigurojnë transportin shtëpi–institucion parashkollor të fëmijëve dhe anasjelltas,		Saktë
2691	Shërbimet e rregullta të specializuara janë shërbimet që sigurojnë transportin shtëpi-institucion shkollor të parauniversitarëve dhe anasjelltas		Saktë
2692	Mjetet e transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve duhet të jenë të pajisura me certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore		Saktë
2693	Mjetet e transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve duhet të jenë të pajisura me akt vlerësimin e kushteve të komoditetit të autobusëve në transportin e udhëtarëve brenda vendit		Saktë
2694	Mjetet e transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve duhet te jenë të pajisur edhe me certifikatën e transportit brenda vendit të lëshuar në përputhje me licencën përkatëse		Saktë
2695	Mjetet e transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve duhet të jenë të pajisura edhe me autorizim nga Policia Rrugore për plotësimin e kushteve për qarkullim		Gabim
2696	Mjetet e transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve për të qarkulluar duhet të pajisen me një autorizim të veçantë nga DPSHTRr-ja		Gabim
2697	Mjetet e transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studenteve nuk duhet të kenë më shumë se 5 vjet në qarkullim nga data e prodhimit		Gabim
2698	Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve si rregull kryhet vetëm autobusë		Saktë
2699	Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve në zona të veçanta lejohet të bëhet edhe me autoveturë me 8+1 vende të licencuar		Saktë
2700	Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve me autovetura me 8+1 vende bëhet vetëm me miratimin e bashkisë përkatëse		Saktë
2701	Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve kryhet me automjete të miratuara ngjyra e të cilave duhet të jetë portokalli		Saktë
2702	Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve kryhet me automjete që duhet të kenë të shkruar dukshëm në të dy anët e tyre poshtë xhamave, në qendër, me ngjyrë të zezë, fjalët “AUTOBUS SHKOLLE”		Saktë
2703	Automjetet për transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve duhet të kenë të montuar dhe një krah të lëvizshëm pingul me aksin gjatësor, me gjatësi jo më të madhe se 15 cm me tabelën “STOP”		Saktë
2704	Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve kryhet vetëm me autobus dhe në asnjë rast me mjete të llojeve të tjera		Gabim
2705	Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve me autovetura me 8+1 vende bëhet vetëm me miratimin e DPSHTRR-së		Gabim

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
2706	Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve kryhet me mjete të miratuara ngjyra e të cilave përcaktohet nga bashkia përkatëse		Gabim
2707	Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve kryhet me mjete të cilat duhet të kenë të vendosur, në qendër të faqeve anësore dhe pas, sinjalin Nr.219, "autobus shkolle"		Saktë
2708	Automjetet e licencuar për transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar duhet të kenë detyrimisht dhe dalje emergjence		Saktë
2709	Automjetet e licencuar për transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar duhet ti kenë të gjitha ndenjset me rripa sigurimi funksional dhe/ose të pajisura secila edhe me ndenjse të posaçme për fëmijët nga 4 deri në 12 vjeç		Saktë
2710	Automjetet e licencuar për transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, në intervalin kohor midis vajtjes dhe ardhjes, nëse nuk bëhen pengesë, mund të përdoren edhe për transportin në shërbimet e udhëtarëve linjave të rregullta ose të rastit		Gabim
2711	Certifikata e operimit e një automjeti të destinuar për shërbimet e rregullta të specializuara për parashkollorët, parauniversitarët dhe studentët, mund të transferohet		Gabim
2712	Drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar, ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët duhet të ketë kryer/përfunduar, të paktën arsimin e mesëm		Saktë
2713	Drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar, ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët duhet që në varësi të mjetit që do drejtojë, të jetë pajisur me lejedrejtimi të një prej kategorive D1, D1E, D ose DE		Saktë
2714	Drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar ose për llogari të vet për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët duhet të jetë pajisur me Certifikatën e Aftësisë Profesionale (CAP) për transportin e udhëtarëve		Saktë
2715	Drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar, ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët duhet të ketë reputacion dhe sjellje të mirë		Saktë
2716	Drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar, ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët duhet të ketë kryer/përfunduar, të paktën arsimin 9 vjeçar		Gabim
2717	Drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar, ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët duhet të jetë pajisur detyrimisht me lejedrejtimi të kategorisë DE		Gabim
2718	Për të ushtruar aktivitetin, drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar, ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët, duhet të vërtetoj me dokument të lëshuara nga qendrat shëndetësore se nuk është përdorues i alkoolit, lëndëve droguese ose psikotrope		Saktë
2719	Për të ushtruar aktivitetin, drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar, ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët, duhet të vërtetoj se nuk është ndëshkuar nga organet e policisë rrugore për drejtimin e mjetit nën efektin e alkoolit, lëndëve droguese ose psikotrope		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
2720	Për të ushtruar aktivitetin, drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar, ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët, duhet të vërtetojë se nuk është dënuar asnjëherë më parë nga organet e drejtësisë për trafikim të qenieve njerëzore apo drogës dhe për vepra penale kundër personit		Saktë
2721	Drejtuesi i mjetit të transport të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët duhet të jetë i veshur me uniformë dalluese		Saktë
2722	Drejtuesi i mjetit të transport të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët në uniformën e tij dalluese, duhet të ketë vendosur në kraharor, mbi xhaketë ose këmbishë distinktivin (shenja dalluese) të përcaktuara nga institucioni mësimor		Saktë
2723	Drejtuesi i mjetit të transport të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët ka përgjegjësi mbi sigurinë e nxënësve të institucioneve arsimore parashkollore, parauniversitare dhe studentëve gjatë shërbimit të transportit		Saktë
2724	Drejtuesi i mjetit të transport të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët mund të përdor çfarëdo veshje, mjafton të ketë vendosur në kraharor, mbi xhaketë ose këmbishë distinktivin (shenja dalluese) të përcaktuara nga institucioni mësimor		Gabim
2725	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar ka përgjegjësi për verifikimin, kontrollin dhe sistemimin e tyre në ndenjese përpara se mjeti të fillojë lëvizjen		Saktë
2726	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar ka për detyrim të evitojë çdo sjellje të rrezikshme brenda në automjet gjatë udhëtimit		Saktë
2727	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar duhet të rrisë në maksimum sigurinë gjatë zbritjes dhe hipjes të së tyre në ndalesat e paracaktuara		Saktë
2728	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar ka përgjegjësi për marrjen, shoqërimin dhe dorëzimin e tyre te prindërit, në vendin e paracaktuar për ndalimin e mjetit, ose qëndrimin të përkohshëm		Saktë
2729	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar ka për detyrë të evitojë në çdo rast sjelljen jo korrekte të nxënësve që transporton		Saktë
2730	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar duhet të raportojë në drejtorinë e institucionit shkollor për sjelljet e tyre problematike		Saktë
2731	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar ka përgjegjësi për verifikimin dhe kontrollin e ushqimeve që ata përdorin në mjet, gjatë lëvizjes		Gabim
2732	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar është i detyruar të verifikoi gjendjen shëndetësore të nxënësve që transporton para hipjes në mjet		Gabim
2733	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar duhet të zbrisë menjëherë nga mjeti nxënësin që demonstron veprime problematike		Gabim
2734	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar duhet të ketë me vete edhe listën me numrat e telefonave të prindërve të nxënësve që transporton		Saktë



**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
2735	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar duhet të dijë adresat e shtëpisë së secilit prej nxënësve që transporton		Saktë
2736	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar duhet të dijë edhe numrat e telefonave të emergjencave civile (policia e shtetit, urgjenca mjekësore dhe shërbimi zjarrfikës etj.)		Saktë
2737	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar duhet të zotëroi, çdo të dhënë tjetër të nevojshme, për mbarëvajtjen e transportit të tyre		Saktë
2738	Drejtuesi i mjetit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar duhet të dijë adresat e shtëpisë së secilit prej tyre si dhe për çdo eventualitet edhe të afërme të tyre		Gabim
2739	Drejtuesit e mjeteve të transportit për të tretë, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit janë të detyruar të paraqesin, përveç lejes së qarkullimit, asaj të drejtimit dhe certifikatës së aftësisë profesionale dhe certifikatën e operimit të autobusit		Saktë
2740	Drejtuesit e mjeteve të transportit për të tretë, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit duhet tu paraqesin edhe kopjen e kontratës ndërmjet organizatorit dhe transportuesit e barasvlershme me origjinalin		Saktë
2741	Drejtuesit e mjeteve të transportit për të tretë, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit janë të detyruar të paraqesin edhe certifikatën e kualifikimit profesional CAP		Saktë
2742	Drejtuesit e mjeteve të transportit për të tretë, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit duhet të paraqesin edhe aktin e vlerësimit të plotësimit të kushteve të komoditetit të mjetit që drejton		Saktë
2743	Drejtuesit e mjeteve të transportit për të tretë, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit janë të detyruar të paraqesin licence, vetëm në origjinal		Gabim
2744	Drejtuesit e mjeteve të transportit për të tretë, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit të paraqesin certifikatën e kualifikimit profesional CAP, nuk janë të detyruar të paraqesin lejedrejtimin		Gabim
2745	Drejtuesit e mjeteve të transportit për të tretë, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit certifikatën e operimit, nuk janë të detyruar të paraqesin, aktin e vlerësimit të plotësimit të kushteve të komoditetit		Gabim
2746	Drejtuesit e mjeteve të transportit për llogari të institucionit, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit duhet të paraqesin kopjen origjinale të certifikatës që lëshohet në emër të institucionit		Saktë
2747	Drejtuesit e mjeteve të transportit për llogari të institucionit, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit duhet të paraqesin dokumentin që dëshmon se drejtuesi i mjetit është anëtar i stafit të institucionit ose i punësuar me kontratë		Saktë
2748	Drejtuesit e mjeteve të transportit për llogari të institucionit, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit duhet të paraqesin dokumentin që dëshmon se veprimtaria e transportit është vetëm një aktivitet ndihmës i institucionit (lista e parashkollorëve, parauniversitarëve dhe studentëve)		Saktë

**PYETESOR TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Figura</b>	<b>Përgjigja</b>
2749	Drejtuesit e mjeteve të transportit për llogari të institucionit, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit duhet të paraqesin edhe certifikatën e operimit të autobusit		Saktë
2750	Drejtuesit e mjeteve të transportit për llogari të institucionit, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit duhet të paraqesin edhe certifikatë e kualifikimit profesional (CAP)		Saktë
2751	Drejtuesit e mjeteve të transportit për llogari të institucionit, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit duhet të paraqesin aktin e plotësimit të kushteve të komoditetit të mjetit		Saktë
2752	Drejtuesit e mjeteve të transportit për llogari të institucionit, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, kur u kërkohet prej organeve të kontrollit janë të detyruar të paraqesin licencën, vetëm në origjinal		Gabim
2753	Drejtuesit e mjeteve të transportit për llogari të institucionit, të nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar, nuk janë të detyruar të pajisen me Certifikatën e Aftësisimit Profesional (CAP) për transportin e udhëtarëve		Gabim
2754	Pajisja e drejtuesit të mjetit me Certifikatën e Aftësisë Profesionale (CAP) për udhëtarë , është një kusht i domosdoshëm në transportin e udhëtarëve me autobus		Saktë
2755	Në fillim të udhëtimit është e nevojshme të kontrolloni nivelin e alkoolit të frenave, lëngun e baterisë dhe gjendjen e teheve të fshirësit		Saktë
2756	Në fillim të udhëtimit, drejtuesi i mjetit nuk është i detyruar të kontrollojë për ndonjë rrjedhje alkooli nga tubat e sistemit të frenimit pasi kjo është në çdo rast përgjegjësi e pronarit të mjetit		Gabim
2757	Para çdo udhëtimit, drejtuesi i mjetit, duhet të kontrollojë pozicionin, pastërtinë dhe gjendjen e përgjithshme të pasqyrave të pamjes së pasme të automjetit		Saktë
2758	Presioni i fryrjes së gomave të autobusit duhet të kontrollohet dhe krahasohet me vlerat minimale të treguara në lejen e qarkullimit të tij		Gabim
2759	Pastrimi i xhamit të përparmë është gjithashtu i rëndësishëm për funksionin dhe jetëgjatësinë e fshirëseve të fshirësit		Saktë
2760	Pastrimi i xhamit të përparmë nuk lidhet me funksionin dhe jetëgjatësinë e fshirëseve të fshirësit		Gabim
2761	Para fillimit të udhëtimit, duhet të kontrollohen nivelet e vajit të motorit, lëngut ftohës dhe lëngut larës të xhamave		Saktë
2762	Përpara fillimit të udhëtimit, drejtuesi duhet të kontrollojë funksionimin e të gjitha pajisjeve të ndriçimit dhe sinjalizimit		Saktë
2763	Para fillimit të udhëtimit, duhet të kontrollohen gjithmonë nivelet e vajit të kutisë së shpejtësisë dhe diferencialit		Gabim
2764	Nëse pasqyrat e pamjes së pasme në njërin anë janë të ndotura ose të dëmtuara, nuk ka asnjë rrezik nëse ato në anën tjetër janë në rregull		Gabim
2765	Nëse pasqyrat e pamjes së pasme janë rregulluar mirë, nuk ka pjesë të rrugës që shoferi nuk mund t'i shohë qartë		Gabim
2766	Nëse automjeti juaj është i pajisur me airbag përpara dhe anësorë, mund të mos përdorni rripin e sigurimit		Gabim

**STRUKTURA E TESTIT TEORIK PER LEJEDREJTIMI TE KATEGORIVE D1 DHE D KUR MERREN NGA KATEGORIA B**

TEMA	TEMA	PYETJET			
		Sasia	Fillon	Mbaron	Ne test
I	PERIUDDHA E DREJTIMIT DHE PUSHIMIT. RREGULLAT PËR KOHËN (ORËT) E DREJTIMIT TË MJETIT DHE PERIUDDHAT E PUSHIMIT	45	1	45	2
II	PAJISJA REGJISTRUESE (TAHOGRAFI). PËRDORIMI I PAJISJEVE TË REGJISTRIMIT	85	46	130	2
III	LEGJISLACIONI PËR TRANSPORTIN E UDHETAREVE	246	131	376	3
IV	DOKUMENTET E MJETIT DHE QARKULLIMIT QË KËRKOHEN PËR TRANSPORTIN KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR TË UDHETAREVE	89	377	465	3
V	SJELLJA NË RASTET E AKSIDENTEVE. NJOHJA E MASAVE QË DUHET TË MERREN PAS NJË AKSIDENTI OSE DUKURI TË NGJASHME, DUKE PËRFSHIRË VEPRIME EMERGJENTE SI EVAKUIMI I UDHËTARËVE DHE NJOHURITË BAZË PËR DHËNIEN E NDIHMES SE PARE	165	466	630	3
VI	NJOHURI PËR MONTIMIN, PËRDORIM DHE KUJDESIN PËR GOMAT. MASAT QË MERREN PËR HEQJEN DHE ZËVENDËSIMIN E RROTAVE.	186	631	816	3
VII	RREGULLA PËR PESHAT DHE DIMENSIONET E AUTOMJETEVE NË QARKULLIM. RREGULLA MBI KUFIJTË E SHPEJTËSISË SË KËTYRE MJETEVE	162	817	978	2
VIII	KUFIZIMET E FUSHËPAMJES NË VARËSI TË KARAKTERISTIKAVE TË MJETEVE. LEXIMI I NJË HARTE RRUGORE, PLANIFIKIMI I ITINERARIT, PËRFSHIRË PËRDORIMIN E SISTEMEVE ELEKTRONIKE TË NAVIGIMIT (FAKULTATIV)	94	979	1072	2
IX	LIDHJA E RIMORKIOVE DHE GJYSMËRIMORKIOVE. NJOHURI MBI LLOJET, NDËRTIMI, PJESËT KRYESORE, LIDHJA ,PËRDORIMI DHE MIRËMBAJTJA E PËRDITSHME E SISTEMEVE LIDHËSE	128	1073	1200	2
X	NDËRTIMI DHE FUNKSIONIMI I MOTORËVE ME DJEGIE TË BRENDSHME, LËNGJET (P.SH., VAJI I MOTORIT, LËNGU FTOHËS), SISTEMI I USHQIMIT, SISTEMI ELEKTRIK, SISTEMI I NDEZJES, SISTEMET E TRANSMETIMIT TË LËVIZJES (FRIKSIONI, KUTIA E SHPEJTËSISË ETJ.)	596	1201	1796	3
XI	SISTEMI I LUBRIFIKIMIT DHE SISTEMI I FTOHJES. MBROJTJA NGA NGRICA	120	1797	1916	2
XII	NJOHURI MBI METODAT PËR IDENTIFIKIMIN E SHKAQEVE TË DEFEKTEVE TË ELMENTËVE TË SISTEMIT TË DREJTIMIT DHE SISTEMIT TË SHUARJES SË LËKUNDJEVE (AMORTIZIMIT).	108	1917	2024	3
XIII	FRENIMI DHE PËRSHPEJTIMI. NJOHURI MBI LLOJET, NDËRTIMIN, PJESËT KRYESORE. MIRËMBAJTJA E PËRDITSHME E SISTEMEVE. RREGULLATORI I SHPEJTËSISË (BLLOKAZHI), DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT KUNDËR BLLOKIMIT FRENAVE (ABS)	209	2025	2233	3
XIV	DËFËKTET DHE PËRCAKTIMI I SHKAKUT TË AVARIVE	220	2234	2453	3
XV	MIRËMBAJTJA E MJETEVE DHE RIPARIMET E ZAKONSHME	115	2454	2568	2
XVI	PËRGJEGJËSIA E DREJTUESIT TË MJETIT NDAJ PERSONAVE TË TRANSPORTUAR, KOMODITETIN DHE SIGURINË E PASAGJERËVE, TRANSPORTIN E FËMIJËVE DHE KONTROLLET E NEVOJSHME PARA NISJES.	198	2569	2766	2
<b>Gjithsej në test</b>					<b>40</b>